



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në: “Financë”

ofruar nga

Universiteti i Tiranës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.Dr Drini Salko

Prof.Asoc. Orkida Hollari

Nëntor / 2025

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT
BACHELOR NË “FINANCË”**

1	IAL aplikues:	Universiteti i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Financës & Departamenti i Kontabilitetit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Financë”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM nr.359, datë 21.09.1991* Urdhër MAS Nr.110, datë 04.03.2022
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër MASH Nr. 297, datë 20.07.2012 **
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Akreditim për herë të parë
8	Cikli i studimit:	Cikli i Parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 (tre) vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 kredite (ECTS)
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe / Angleze
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	N/A
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	N/A
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	N/A
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli i 6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2022-2023 – 104 PAE / 78 PAK; 2023-2024 – 113 PAE / 71 PAK; 2024-2025 – 106 PAE / 67 PAK;
18	Numri i studentëve:	<u>Studentë të regjistruar ne gjuhën shqipe:</u> 2022-2023 – 453 studentë; 2023-2024 - 437 studentë; 2024-2025 - 441 studentë;

		<u>Studentë të regjistruar ne gjuhën anglze:</u> 2022-2023 – 38 studentë; 2023-2024 - 30 studentë; 2024-2025 - 24 studentë;
19	Komente / të tjera:	<i>Emërtimi i programit sipas aktit të licensimit është dega “financë – kontabilitet”;</i> <i>ndërsa sipas urdhërit për regjistrimin e formës së diplomës është: Bachelor në: “Financë”;</i>

**Emërtimi sipas aktit të licensimit është dega “financë – kontabilitet”;*

*** Emërtimi sipas urdhërit për regjistrimin e formës së diplomës është: Bachelor në: “Financë”;*

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti i Tiranës (UT) është institucion publik i arsimit të lartë, i hapur me Vendimin Nr. 207, datë 30.05.1957 të Këshillit të Ministrave, i cili ka ofruar studime të nivelit universitar në gjashtë Institutet e tij. Përgjatë viteve ky institucion ka pësuar një sërë ndryshimesh, kryesisht në strukturën e tij. UT ushtron aktivitetin e tij në Tiranë, me adresë qendrore: Sheshi “Nënë Tereza”, Tiranë, dhe në Filialin e tij në qytetin e Sarandës. Sipas strukturës aktuale, ky universitet përbëhet nga një filial, gjashtë fakultete dhe dy institute.

Universiteti i Tiranës ka kaluar disa procese akreditimi institucionale, ku së fundmi është akredituar institucionalisht me vendimin Nr. 04, datë 27.01.2023 të Bordit të Akreditimit, me kohëzgjatje 6 vite, me afat vlefshmërie deri në 26.01.2029.

Programi i studimit objekt vlerësimi Bachelor në “Financë”, është hapur për herë të parë sipas VKM nr.359, datë 21.09.1991, me emërtimin (dega financë-kontabilitet). Sipas Urdhërit të MASH Nr. 297, datë 20.07.2012 “Për rregjistrimin e formës së diplomave të programeve të studimeve “Bachelor”, “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave” të Universitetit të Tiranës”, emërtimi i këtij program studimi është Bachelor në “Financë”. Sipas Urdhërit të MAS nr.110, datë 04.03.2022, ky program studimi ofrohet edhe në gjuhën angleze.

Programi organizohet nga Departamenti i Financës dhe Departamenti i Kontabilitetit me mbështetjen e Fakultetit Ekonomik njësi baze tashme të konsoliduar prej shumë vitesh. Ky program studimi synon të ofrojë arsim të një niveli të lartë shkencor dhe profesional, njohuri të thelluara teorike dhe praktike si dhe trajnim për kërkim shkencor në fushën e financës, bankës dhe kontabilitetit. Ky program studimi akreditohet për herë të parë.

Programi i studimit Bachelor në Financë ofrohet në gjuhën shqipe dhe anglisht dhe është programi më i hershem i arsimit të lartë shqiptar dhe njëkohësisht programi me numrin më të lartë të aplikimeve nga kandidatet në fushën e financës pas ndryshimeve politiko ekonomike në Shqipëri. Në përfundim të studimeve në këtë program studimi lëshohet diplome e nivelit Bachelor në Financë.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), i përbërë nga **Prof. Dr. Drini Salko** dhe **Prof. Asoc. Dr. Orkida Ilollari**, i miratuar nga Bordi i Akreditimit dhe ASCAL, u mbështet gjatë këtij procesi nga koordinatori teknik i ASCAL, znj. Majlinda Demimeli. GVJ analizoi dokumentacionin e ofruar nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit të Lartë (ASCAL) si dhe materialet shtesë të dorëzuara nga institucioni përkatës. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB), rezultat i bashkëpunimit të stafit akademik dhe administrativ, përbënte një burim të rëndësishëm për vlerësimin e jashtëm, duke reflektuar situatën aktuale të Fakultetit të Ekonomisë të Universitetit të Tiranës (FEUT), përfshirë Departamentin e Financës dhe Departamentin e Kontabilitetit, përgjegjës për programin e studimit Bachelor në “Financë”.

Gjatë vizitës në institucion më 15-16 shtator 2025, GVJ zhvilloi takime me drejtues të njësive kryesore dhe strukturat përkatëse të FEUT, shqyrtoi dokumentacionin e akreditimit dhe kreu intervista me hartuesit e RVB-së, anëtarët e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm (GVB), stafin akademik dhe administrativ, si dhe studentët e programit. Inspektimi përfshiu gjithashtu ambientet universitare që shërbejnë programin.

Raporti i Vlerësimit të Jashtëm (RVJ) strukturohet mbi gjashtë standarde kryesore, ku secili analizohet në bazë të kritereve përkatëse, duke u vlerësuar mbi të dhënat e RVB-së, evidencat shtesë dhe materialet e mbledhura gjatë vizitës. Ekspertët shqyrtuan ndryshimet e bëra dhe ndikimin e tyre në përmbushjen e standardeve, duke dhënë për secilin standard një vlerësim të qartë dhe komente të detajuara.

Gjatë verifikimit të të dhënave, u përzgjedhën kampionë në mënyrë të rastësishme për të kryer kontrollin dhe vlerësimin e cilësisë së studentëve, të dhënave në sekretari, hyrjeve dhe daljeve të studentëve, frekuentimit të leksioneve dhe seminareve, si dhe praktikave të rekrutimit të stafit.

GVJ vlerësoi angazhimin dhe bashkëpunimin e të gjitha strukturave të institucionit, të cilat siguruan dokumentacionin shtesë të nevojshëm dhe mundësuan një vlerësim të paanshëm. Raporti është përgatitur në koordinim të ngushtë nga ekspertët e jashtëm dhe pasqyron mendimet e tyre të integruara.

Universiteti i Tiranës, është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 17.10.2025, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 138/10 Prot, datë 17.10.2025. Universiteti i Tiranës njofton më datë 29.10.2025, nëpërmjet shkresës me nr. 2683/5, prot, datë 28.10.2025, "Kthim përgjigje shkresës me nr 138/10 Prot, datë 17.10.2025", komentet mbi draft raportin.

Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:

1. Në lidhje më emërtimin e programit të studimit, GVJ është shprehur se ky program studimi, sipas aktit të licensimit VKM nr.359, datë 21.09.1991 e ka emërtimin dega "financë – kontabilitet", por sipas Urdhërit MASH Nr. 297, datë 20.07.2012, për regjistrimin e formës së diplomës emërtimi i këtij program studimi është: Bachelor në: "Financë", emërtim ky me të cilin studentët marrin diplomën e studimit, ndaj GVJ në këtë rast mban të njëjtin vlerësim, **raporti nuk ndryshon.**
2. **Duke ju referuar standartit I.1.Kriteri 5**, në lidhje me saktësimin edhe të fushës së kontabilitetit, GVJ sqaron se, është përcaktuar përgjegjësia e të dy departamenteve DF dhe DK. Në raport është theksuar disa herw që programi ofron njohuri bazë të financës dhe kontabilitetit. Në këtë kontekst ne shtojmë tek ky kriter në fund të paragrafit të parë fjalën "kontabilitet", **pra raporti ndryshon.**
3. **Duke ju referuar standardit II.1, kriteri 2**, GVJ sqaron se, argumentet për këto dy rekomandime janë dhënë në raport bazuar në evoluimin e tregut të punës, ndaj GVJ në këtë rast mban të njëjtin vlerësim, **raporti nuk ndryshon.**
4. **Duke ju referuar standardit II.1, kriteri 6**, GVJ sqaron se, në shumw pjesw të raportit tonë theksohet ofrimi i njohurive të kontabilitetit nga ky program. Duke ditur që njohuritë e financës janë të lidhura drejtpërdrejt me ato të kontabilitetit gjë që reflektohet në të gjitha programet e këtyre dy fushave pavarësisht emërtimit që mund të kenë, "Financë", "Finance Kontabilitet" apo dhe vetë "Kontabilitet". GVJ vlerëson se programi ofron njohuritë e duhura të kontabilitetit pavarësisht se emërtimi i tij është thjesht financë, ndaj GVJ në këtë rast mban të njëjtin vlerësim, **raporti nuk ndryshon.**
5. **Duke ju referuar standardit II.2, kriteri 1**, mbi saktësimin e stafit PAK për vitin 2024-2025, të deparatamentit të kontabilitetit, GVJ sqaron se këto shifra të dhëna ne raport janë bazuar sipas (*Evidenca 0.3_Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB.pdf, tabela nr. 1*), ku përsëri u bë një verifikim dhe rezultojnë po këto shifra, ndaj GVJ në këtë rast mban të njëjtin vlerësim, **raporti nuk ndryshon.**
6. **Duke ju referuar Standardeve II.4. kriteri 2, kriteri 4, kriteri 6, Standardi II.5 kriteri 1, Standardi III.1. kriteri 1, Standardi III.2.kriteri 1, Standardi III.3.kriteri 8, Standardi III.5.kriteri 3**, kërkojnë saktësime të disa shifrave apo vetëm të fjalëve, **GVJ sqaron se këto saktësime janë bërë në Raportin final.**

7. Duke ju referuar **Standardi IV.1, Kriteri 1**, GVJ sqaron se, është bërë sistemi dhe riformulimi i fjalës përkatëse si: *“Të dhënat mbi stafin e përfshirë në mësimdhënie për këtë program gjatë tre viteve të akademike për të dy departamentet përgjegjës janë”*.
8. Duke ju referuar **Standardit IV.2, Kriteri 4**, GVJ sqaron se është bërë një plotësim i paragrafit përkatës, duke shtuar: *“Gjithashtu, programi zhvillohet edhe në tre salla laboratorike, ku janë instaluar programet Balance dhe Alpha, të cilat mbështesin procesin mësimor dhe zhvillimin praktik të studentëve në fushën e financës dhe kontabilitetit.”*
9. Duke ju referuar **standartit II.2, kriterit 2**, në lidhje me ndryshimet në programet e lendeve, sqarojmë se stafi akademik gjatë viteve të fundit ka bërë përshtatje të vazhdueshme në përputhje me zhvillimet e tregut, duke ruajtur në të njëjtën kohë stabilitetin dhe koherencën e programit të studimit, kjo përputhet plotësisht me konstatimin tuaj në raport ku programi vlerësohet si një program i konsoliduar, i reformuar dhe i strukturuar në vite, por nisur nga fakti që gjatë 3 viteve të fundit nuk ka pasur ndryshime në të në kuadër të kufirit të 20 % GVJ ka rekomanduar axhustime të vogla në program si dhe kalimin e disa lendeve karakterizuese që janë me zgjedhje si të detyrueshme dhe kalimin me zgjedhje të disa lëndëve të fushës së menaxhimit apo marketingut. GVJ në këtë rast mban të njëjtin vlerësim, **raporti nuk ndryshon.**
10. Duke ju referuar **standartit VI.1, kriterit 3**, sa i takon përqindjes së plotësimit të pyetësorëve nga studentët (31%), si dhe mungesës së përfshirjes së sugjerimeve të studentëve në raportin e NJSBC, GVJ shprehet se në lidhje me rritjen e numrit të studentëve të përfshirë aktivisht në procesin e vlerësimit të cilësisë, sqarojmë se numri aktualisht i kufizuar i studentëve ka ndikuar që të mos mblidhen mjaftueshëm mendime dhe vlerësime të drejtpërdrejta mbi zbatimin dhe përmbajtjen e programit të studimit. GVJ në këtë rast mban të njëjtin vlerësim, **raporti nuk ndryshon.**

LISTA E SHKURTIMEVE



ASCAL	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë
FE	Fakulteti i Ekonomisë
GVB	Grupi i Vlerësimit të Brendshëm
GVJ	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm
IAL	Institucion i Arsimit të Lartë
KPSSC	Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë
NJSBC	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
PAE	Personeli Akademik Efektiv
PAK	Personeli Akademik me Kontratë
QSHA	Qendra e Shërbimeve Arsimore
RVB	Raport i Vlerësimit të Brendshëm
RVJ	Raport i Vlerësimit të Jashtëm
SBC	Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë
UT	Universiteti i Tiranës
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Financë”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Programi i studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Financë” që ofrohet nga Fakulteti i Ekonomisë (FE) i Universitetit të Tiranës (UT) nuk bie ndesh me interesa kombëtare. Programi bazohet në Statutin e institucionit si dhe përkon edhe me zhvillimin institucional, akademik dhe shkencor të përcaktuara në strategjinë e UT për mësimdhënien për periudhën 2022-2027 dhe strategjinë e zhvillimit të institucionit 2023-2028.</p> <p>Ky program studimi me historikun me të gjatë të programeve të studimit në Shqipëri në fushën e financës zhvillohet i bazuar në strategjinë kombëtare të arsimit të lartë krahas strategjive të institucionit. Studentet që përfundojnë këtë program kanë mundësi që në kuadër të zhvillimeve ekonomiko sociale të dekadës së fundit të jenë pjesë e tregut të punës në funksion të kontributit të tyre në nivel lokal, rajonal apo edhe kombëtar.</p> <p><i>Evidence nr. 1.1. Statuti i UT</i></p> <p><i>Evidence nr.1.3.Strategjia e zhvillimit të UT 2023-2028</i></p> <p><i>Evidence nr. 1.4.Strategjia e UT për mësimdhënien 2022-2027</i></p>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Programi i studimit Bachelor në “Financë” është hartuar në zbatim të Ligjit në fuqi për Arsimin e Lartë, akteve nënligjore dhe kuadrin rregullues të tij si dhe në dy Strategjinë e UT-së (përkatësisht pika 1.1 dhe 3). Ky program reflekton vlerat akademike e kulturore standarde të arsimit të lartë në Shqipëri. Ky vlerësim bazohet në plotësimin e kriterëve thelbësorë të këtij programi në aspektin akademik dhe atë kulturor bazuar në Statutin e UT. Porë në tërësi, programi synon përcjelljen tek studentët si të vlerave akademike, ashtu dhe të atyre kulturore në shërbim të ekonomisë të vendit në përgjithësi dhe të sektorit financiar në veçanti .</p> <p><i>Evidence nr 1.1. Statuti i UT</i></p> <p><i>Evidence nr.1.3.Strategjia e zhvillimit të UT 2023-2028</i></p> <p><i>Evidence nr. 1.4.Strategjia e UT për mësimdhënien 2022-2027</i></p> <p><i>Evidence nr.04. Dosja e programit të studimit (pika IV).</i></p>

<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.</p>	<p>Programi i studimit të Ciklit të Parë Bachelor në Finance që ofrohet nga FE i UT është bazuar në dokumentet themelore të zhvillimit institucional. Ky program është në funksion të zbatimit të vizionit, prioriteteve dhe objektivave të vendosura në Strategjitë e zhvillimit institucionale të periudhës 2023-2028. Kështu, mund të përmendim objektivin strategjik pika 1 si dhe në piken 5 ku sanksionohet promovimi i formimit të vazhduar për stafin akademik dhe studentet. Edhe në rregulloren e programeve të studimit Bachelor përcaktohen objektivat kryesor të tyre (neni nr.5)</p> <p><i>Evidence nr. 1.1. Statuti i UT</i></p> <p><i>Evidence nr.1.3.Strategjia e zhvillimit te UT 2023-2028</i></p> <p><i>Evidencë nr. 1.4.Strategjia e UT për mësimdhënien 2022-2027</i></p> <p><i>Evidence nr.04. Dosja e programit te studimit (pika IV).</i></p> <p><i>Evidence nr.2.36 Rregullore e programit Bachelor , FEUT</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Historiku i gjatë, madhësia, organizimi i UT, struktura hierarkike është e ndërtuar në mënyrë të tillë që të përmbushë plotësisht misionin dhe objektivat e përcaktuara prej tij por edhe të programit Bachelor në "Finance", duke pasur edhe përvojën, kapacitetet dhe burimet njerëzore të përshtatshme për një mision të tillë. UT është institucioni i arsimit të lartë me i madh në vend tashme i akredituar dhe që përfshin 6 fakultete ku Fakulteti i Ekonomisë si njësi kryesore e këtij programi vepron si i tillë që në vitin 1957.</p> <p>Që në fillimin e tranzicionit ekonomik në vitet 1990 FE operon me programe të reformuara dhe ristrukturuara duke ju përshtatur ekonomisë së tregut dhe ndryshimeve të tjera politiko sociale. FE ka 168 PAE dhe 214 PAK të përfshirë në 6 departamente nga të cilat Departamenti i Financës (DF) dhe Departamenti i Kontabilitetit (DK) si njësi baze janë dy departamentet përgjegjëse që mbulojnë këtë program studimi. FE dhe dy njësitë baze DF dhe DK kanë kapacitetet akademike tashme të konsoliduar prej vitesh duke fituar reputacionin brenda dhe jashtë vendit dhe duke garantuar zhvillimin me sukses të këtij programi studimi në të dy gjuhët që ai ofrohet, shqip dhe anglisht.</p> <p><i>Evidence nr. 0.3. Tabela përmbledhëse .Aneks i RVB</i></p> <p><i>Evidence nr.3.06.Plani mësimor në vite</i></p> <p><i>Evidence nr.3.5.Plani mësimor i programit</i></p>
<p>Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të</p>	<p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është plotësisht në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë baze përgjegjëse për këtë program studimi që është</p>

<p>studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>DF dhe DK qe mbulojnë këtë program, i cili që në emërtim është i njëjtë me objektivin e këtij programi dhe që gjithashtu ka pjesën me të madhe të stafit të programit nga fusha e financës dhe kontabilitetit.</p> <p>Programi Bachelor në 'Financë' funksionon në përputhje të plotë me Statutin dhe Rregulloren e UT, si dhe Rregulloren e Programit të Studimit. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është relativisht në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore përgjegjëse për këtë program studimi që është FE si një ndër Fakultetet e UT. Programi Bachelor në Financë është i klasifikuar në përputhje me aktet ligjore në nivelin 6 të kornizës shqiptare të kualifikimeve dhe është i kodifikuar në përputhje me udhëzimet e dhëna nga VKM nr.310, datë 15.11.2022</p> <p><i>Ligji Nr. 80/2015;</i></p> <p><i>Evidence nr. 0.3. Tabela përmbledhëse .Aneks i RVB</i></p> <p><i>Evidence nr.2.29.Forme diplome dhe kodet e programit</i></p> <p><i>Evidence nr. 2.29.1.Ndryshimi i emërimit të degës për vitin akademik 1993-1994</i></p> <p><i>Evidence nr.3.5.Plani mësimor i programit</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se programi i studimit Bachelor në Financë është në përputhje me misionin dhe qëllimin e veprimtarisë të UT, duke ruajtur interesat dhe vlerat kombëtare dhe në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore dhe asaj bazë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi I.2</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi</p>	<p>Marrëdhëniet e bashkëpunimit brenda UT si institucion dhe brenda FE si njësi kryesore e programit dhe ndarja e detyrave dhe përgjegjësive mes njësisë kryesore, njësisë bazë dhe gjithë strukturave mbështetëse të programit, janë të sanksionuar në një sërë aktesh rregullative dhe mbikëqyrëse, si statutin e UT</p>

<p>brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>(neni 11, pika V, neni 12, 14 dhe 19) rregullore e UT (kreu III), rregullore e programit të studimit Bachelor në FK dhe në udhëzime që përcaktojnë procedurat në funksion të këtij qëllimi. Po ashtu janë një sërë aktesh të tjera që disiplinojnë punën e dekanatit, departamentit, sekretarisë mësimore, zyrës së burimeve njerëzore apo hallkave të ndryshme të institucionit në të cilat përcaktohen rolet, funksionet dhe ndarja e përgjegjësive e tyre të cilat i shërbejnë mbarëvajtjes së programit të studimit.</p> <p>Struktura e institucionit përfshin të gjitha hallkat e nevojshme në funksion të procesit mësimor shkencor ashtu edhe të zbatimit dhe monitorimit të standardeve të cilësisë në procesin e mësimdhënies dhe mësim nxënies duke përfshirë edhe ato në funksion të ndryshimeve ligjore dhe nënligjore (NJSBC, Komisioni i Përhershëm i Garantimit të Sigurimit të Cilësisë)</p> <p>Institucioni nxit dhe motivon bashkëpunimin e ngushtë të personelit akademik, jo akademik, administrativ dhe studentëve, në përputhje me statutet e tyre, funksionet dhe përgjegjësitë, për arritjen dhe realizimin e qëllimeve institucionale. Në këto dokumente janë të përcaktuar qartë drejtimet e bashkëpunimit dhe ndarja e përgjegjësive të gjitha njërive përkatëse.</p> <p><i>Evidencë nr.1.1. Statuti i UT</i> <i>Evidencë nr.1.2.Rregullore e UT</i> <i>Evidencë nr. 2.36. Rregullore e programit bachelor FE.</i> <i>Evidencë nr.3.11.1 Analize vjetore e Departamenteve DF dhe DK</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Sipas listës së bashkëpunimit ndërinstitutional të UT dhe FE dhe bazuar në tabelën përmbledhëse statistikore të RVB nr. 5 dhe evidencën nr.2.21 si dhe në konkluzionet e nxjerra nga raporti i vlerësimit të brendshëm, UT ka 45 marrëveshje bashkëpunimesh me aktorë të biznesit, institucione publike dhe private, bashkëpunime ndërinstitutionale me një sërë institucioneve shtetërore dhe IAL brenda vendit dhe 26 me ato jashtë vendit. Si institucioni më i madh dhe i hershem i Arsimit të Lartë UT ka një sere marrëveshjes bashkëpunimi në rolin e partnerit në kuadër të programeve TEMPUS, ERASMUS Mundus Action2, IPA, Eureka etj. Personeli akademik i programit dhe studentet e këtij programi studimi janë përfitues të mobiliteteve të shumta në këto universitete partnere..</p> <p><i>Evidencë nr2..21. Marrëveshjet ndërinstitutionale</i> <i>Evidencë nr. 3.1. Lista e mobiliteteve për stafin dhe studentet.</i></p>

	<i>Evidence nr.03. Tabelat përmbledhëse statistikore anekse të RVB (tabela nr. 5)</i>			
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	<p>Bazuar në listën e marrëveshjeve të bashkëpunimit mes UT dhe institucioneve të tjera apo aktoreve të sipërmarrjes por edhe të marrëveshjeve që vete FE si njësi kryesore e programit (janë 49 marrëveshje të tilla në nivel fakulteti) shikojmë se një numër i konsiderueshëm e tyre ofrojnë mundësinë e realizimit të praktikave profesionale për studentët e këtij programi. Ky numër marrëveshjesh plotëson edhe qëllimin e realizimit të praktikës profesionale të studentëve të këtij programi.</p> <p>Kryesisht, objektivat e këtyre bashkëpunimeve janë realizimi i praktikave profesionale me studentët sipas profilit, shkëmbimi i përvojave reciproke, krijimi i mundësive të punësimit të studentëve dhe në profil pas përfundimit të studimeve.</p> <p><i>Evidencë nr.2..21. Marrëveshjet ndërinstytucionale</i></p> <p><i>Evidence nr. 3.1. Lista e mobiliteteve për stafin dhe studentet.</i></p> <p><i>Evidence nr.03. Tabelat përmbledhëse statistikore anekse të RVB (tabela nr. 5)</i></p>			
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësi përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	<p>Referuar listës së bashkëpunimit ndërinstytucional, raportit të vlerësimit të brendshëm, njësite përgjegjëse në funksion të realizimit të programit të studimit, Bachelor në "Financë", DF dhe DK mbajnë evidenca dhe analizojnë përfitimet nga realizimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit. Këto analiza janë pjesë e raporteve vjetore në rang institucioni, njësi kryesore (FE) dhe baze (DF dhe DK).</p> <p><i>Evidence nr.2.35.1.Raport vjetor FE i UT</i></p> <p><i>Evidence nr.3.11.1 Analizë vjetore e Departamenteve DF dhe DK</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se program i studimit Bachelor në "Financë", bazohet në një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh bashkëpunimi mes UT dhe institucioneve publike apo private si dhe sipërmarrjeve të ndryshme si dhe në vete marrëveshjet e FE me aktoret e jashtëm duke mundësuar realizimin e shkëmbimit të përvojës akademike, e praktike, të kualifikimit të stafit si dhe të realizimit të praktikës profesionale dhe marrjen e eksperiencës nga specialistë të fushës jashtë institucionit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
I				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Financë ” që ofrohet nga DF dhe DK i Fakultetit të Ekonomisë pranë UT është i organizuar në 31 module (përfshirë praktikën profesionale) të cilat vlerësohen me kredite përkatëse në përputhje me Ligjin 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe VKM Nr. 41, datë 21.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, ku lëndët e modulet vlerësohen me sistemin e krediteve ECTS dhe orë fizike.</p> <p>Programi bazohet në Sistemin European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ETCS) dhe parimeve të Kartës së Bolonjës. Programi me një kohëzgjatje 3 vite akademike është i ndarë në 6 semestra dhe që përfshin 180 ECTS.</p> <p><i>Evidencë nr.3.6.Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidence nr.03. Tabelat përmbledhëse statistikore anekse te RVB (tabela nr. 10)</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të</p>	<p>Duke shqyrtuar programin mësimor si dhe përmbajtjen e syllabuseve konstatohet që arrihet të transmetohen njohuri të fushës së financës dhe kontabilitetit si dy drejtime kryesore të këtij programi studimi. Kjo bën të mundur që studentët që përfundojnë këtë program mund të punësohen si specialistë në financë, banke dhe kontabilitet brenda hapësirës së njohurive të një programi Bachelor si dhe të mund të vazhdojnë programin e ciklit të dytë në profilet e këtij programi pas diplomimit të tyre. Plani mësimor është i qartë dhe në të janë të paraqitura lëndët/modulet me gjithë ngarkesën e tyre.</p>

<p>përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Megjithatë, vërejmë që gjatë 3 viteve akademike të fundit në këtë program nuk janë bërë ndryshime të mundshme brenda kufirit 20 % që është kompetencë e institucionit.</p> <p><u>Në këtë kuadër do të sugjerim në të ardhmen:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Megjithëse ky program studimi është i konsoliduar prej vitesh mbështetur ne zhvillimet aktuale dhe të perspektives të shërbimeve financiare bashkëkohore do të sugjerim që në vitet e ardhshme të mund të përfshiheshin në lenden “Shërbime Financiare” tema shtese mbi financat digjitale dhe Fintech. Nga shqyrtimi i syllabusve të lendeve dhe takimi me stafin akademik evidentuam përmirësimet që titullarët e lendeve kanë bere në këtë drejtim por që e ardhmja e afërt do të kërkoje përmirësime të mëtejshme;</i> • <i>Për ti dhënë me shume rol objektit të programit në fushën e financës në program lende te tilla si “Shërbimet Financiare”, “Financa Personale” apo “Sistemet e Kompjuterizuara në Kontabilitet” të mos jenë me zgjedhje por të zhvillohen të detyrueshme. Disa lende të menaxhimit si “Menaxhim i Burimeve Njerëzore” “Menaxhim Operacionesh” apo “Menaxhim Marketingu” të mund të kalonin me zgjedhje;</i> <p><i>Evidencë nr.0.4. Dosja e programit të studimit</i> <i>Evidenca nr.2.36.Rregullore e programit të studimit Bachelor</i> <i>Evidencë nr.3.5.Syllabuset e programit të studimit</i> <i>Evidence 3.6.Plani mësimor ne vite</i> <i>Evidence nr.03. Tabelat përmbledhëse statistikore anekse te RVB (tabela nr. 10)</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Mbështetur në pasqyrën e hartuar nga institucioni “Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese”, Tabela nr.9. evidentojmë se organizimi i kurrikulës respekton kriteret e përcaktuara në VKM nr 41, datë 25.01.2018 sipas tipit të veprimtarisë nga A tek E si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lëndët e kategorisë A zënë 18. % të numrit të krediteve ndaj nivelit maksimal prej 20 % që është kriteri; - Lëndët e kategorisë B zënë 53 %; të numrit të krediteve ndaj nivelit maksimal prej 55 % që është kriteri; - Lëndët e kategorisë C zënë 15 %; të numrit të krediteve ndaj nivelit maksimal prej 15 % që është kriteri; - Lëndët e kategorisë D zënë 11 %; të numrit të krediteve ndaj nivelit maksimal prej 15 % që është kriteri;

	<p>- Lëndët e kategorisë E zënë 3 %; të numrit të krediteve ndaj nivelit maksimal prej 5 % që është kriteri (diplomimi);</p> <p>Bazuar në kriteret e miratuara për një program Bachelor shohim se struktura e programit përmbush kriteret e vendosura.</p> <p><i>Evidencë nr.0.4. Dosja e programit të studimit</i></p> <p><i>Evidencë nr.3.5.Syllabuset e programit të studimit</i></p> <p><i>Evidence 3.6.Plani mësimor në vite</i></p> <p><i>Evidence nr.03. Tabelat përmbledhëse statistikore anekse të RVB (tabela nr.9)</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmblylëse.</p>	<p>Programi i studimit është mbështetur në plotësimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore përfshin si komponent më vete praktikën profesionale e cila zhvillohet menjëherë pas përfundimit të procesit mësimor dhe përpara diplomimit të studentëve. Praktika profesionale në planin mësimor është e planifikuar me 80 orë totale dhe me 4 kredite (sistemi ETCS). Programi i studimit përmbillet me punimin e diplomës që është për të gjithë studentet dhe që në planin mësimor ka 6 kredite</p> <p><i>Evidence 3.6.Plani mësimor në vite</i></p> <p><i>Evidence nr.03. Tabelat përmbledhëse statistikore anekse të RVB (tabela nr.10)</i></p>
<p>Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Institucioni mbështetur në kërkesat dhe kriteret ligjore dhe nënligjore në fuqi ka hartuar “Rregullorja e brendshme në UT”. Në këtë dokument janë të përcaktuara procedurat dhe fazat e procesit të pranimit vlerësimit, transferimit dhe financimit të studenteve. Në funksion të këtij qëllimi është edhe rregullorja e vetë këtij programi studimi. UT nuk është IAL me status të veçantë.</p> <p><i>Evidence nr.1.2.Rregullore e UT</i></p> <p><i>Evidence nr.2.36. Rregullore e programit të studimit Bachelor në FE</i></p> <p><i>Evidence 3.6.Plani mësimor në vite</i></p> <p><i>Evidence nr.03. Tabelat përmbledhëse statistikore anekse të RVB (tabela nr.10)</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën përmbledhëse, duhet të</p>	<p>UT dhe FE si njësi kryesore ofron vetëm këtë program studimi në Bachelor në Finance. Nga informacioni që GVJ ka, rezulton se programi Bachelor me këtë emërtim zhvillohet në disa prej në institucionet e tjera të arsimit të lartë në Shqipëri, si</p>

<p>kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë, Universiteti European apo Universiteti Barleti. etj.</p> <p>Përmbajtja e programit duke marrë për bazë fushën e financës në kuadër të gjerë përmban jo me pak se 70 % të lendeve që zhvillohen në këto institucione të ngjashme të nivelit Bachelor. Nga ana tjetër, ky program studimi do ta konsideronim je vetëm me historikun më të gjatë por edhe si më i konsoliduar parë kjo në ecurinë e suksesshme të aplikimeve në fazën e regjistrimit dhe preferencës së tregut për të diplomuarit në këtë program.</p> <p><i>Evidencë nr.3.5.Programet mësimore të lendeve</i> <i>Evidence 3.6.Plani mësimor në vite</i> <i>Evidence nr.03. Tabelat përmbledhëse statistikore anekse te RVB (tabela nr.10)</i></p>
<p>Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Programi është i klasifikuar me kodet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - për gjuhën shqipe -63BA0412S; - për gjuhën angleze, 63BA0412A; <p>në përputhshmëri me kriteret e përcaktuara me Udhëzimin e MAS nr. 31, datë 15.11.2022 “Për procedurat për kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në RSH.</p> <p><i>Evidencë nr.2.29.Forme Diplome dhe Kodet e Programeve</i> <i>Evidencë nr.3.18. Diploma dhe Supplement Diplome</i></p>
<p>Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Programi Bachelor në “Financë” aktualisht nuk është një program i përbashkët me ndonjë institucion tjetër të arsimit të lartë vendas apo të huaj.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se program i studimit Bachelor në “Financë” organizohet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi në strukturë dhe përmbajtje. GVJ sugjeron që në kuadër të zhvillimeve aktuale dhe të perspektives afatshkurtër të tregut financiar e bankar të shihen mundësitë për të përmirësuar më tej programin brenda kufirit të 20 % ndryshimeve kompetence e institucionit.</i></p>

		7 – Dr. në Proc. 0 - Msc		4 – Dr. në Proc. 5 - Msc
Departamenti i Menaxhimit	29	4 – Prof. Dr. 7– Prof. Asoc. 7– Dr. 11 – Dr. në Proc. 0 - Msc	49	1 – Prof. Dr. 2– Prof. Asoc. 11 – Dr. 10 – Dr. në Proc. 25- Msc
Departamenti i Marketing Turizëm	18	4 – Prof. Dr. 4– Prof. Asoc. 6– Dr. 4 – Dr. në Proc. 0 - Msc	36	1– Prof. Dr. 1– Prof. Asoc. 4– Dr. 15 – Dr. në Proc. 15 - Msc
Departamenti i Statistikës dhe Informatikës se Zbatuar	34	6– Prof. Dr. 12– Prof. Asoc. 5– Dr. 11 – Dr. në Proc. 0 - Msc	62	1 – Prof. Dr. 4– Prof. Asoc. 17– Dr. 6 – Dr. në Proc. 34 - Msc
Total		168		221

Departamenti i Financës dhe Departamenti i Kontabilitetit si njësi bazë përgjegjëse për këtë program studimi i plotësojnë kriteret ligjore të përcaktuara, si dhe i përmbushin detyrimet për numrin e personelit dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas viteve akademike që paraqiten si më poshtë vijon:

a. Departamenti i Financës

Tituj/ grada	2022-2023		2023-2024		2024-2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	4	1	4	1	6	
Prof. Asoc.	10	3	10	3	10	3
Dr./PhD.	8	4	8	4	6	5

Dok.në proces dhe MSc	8	38	8	27	7	28
Totali	30	45	30	35	29	36

b. Departamenti i Kontabilitetit

Tituj/ grada	2022-2023		2023-2024		2024-2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	3		3		3	2
Prof. Asoc.	1		1		2	
Dr./PhD.	6		6		8	2
Dok.ne proces dhe MSc	7	9	7	8	9	21
Totali	17	9	17	8	22	25

Siç shihet edhe nga tabelat e mësipërme stafi i të dy departamenteve përgjegjëse për këtë program studimi përmbush kërkesat ligjore, i qëndrueshëm në numër dhe në kualifikimet e kërkuara duke përberë një garanci të madhe për realizimin e këtij programi.

Evidence nr.03. Tabelat përmbledhëse statistikore anekse të RVB (tabela nr.1 dhe 2)

Referenca nr. 3.12.CV e PAE dhe PAK

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.

Realizimi i praktikave profesionale bazohet në marrëveshjet që FE apo UT ka me institucione apo sipërmarrje të ndryshme duke angazhuar në këtë proces edhe PAE me planifikim ngarkese mësimore për ta.

DF dhe DKKane në strukturën e tyre edhe nga 1 personel ndihmës akademik për secilin prej tyre që administrojnë dokumentacionin e departamentit dhe mirëmbajnë apo mbikëqyrjen e laboratorëve. Në rang fakulteti janë edhe 7 punonjës ndihmës akademik pranë departamenteve të tjera. Gjithashtu, koordinatori i programit është edhe personi përgjegjës për ndjekjen e praktikave profesionale të studentëve krahas pedagogeve të caktuar për monitorim gjatë këtij procesi.

	<p><i>Evidence nr.03. Tabelat përmbledhëse statistikore anekse te RVB (tabela nr.1 dhe 2).</i></p> <p><i>Evidence nr.3.14.6.Lista e drejtuesve te diplomave dhe praktikave programi Bachelor 24-25</i></p> <p><i>Takim i GVJ me stafin akademik dhe studentët</i></p>			
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e UT dhe në vendimin e Dekanatit të FE nr.6 date 19.4.2021, Përgjegjësi i njësive bazë është edhe në rolin e koordinatorit të programit. Pra të dy përgjegjësitë e DF dhe DK ushtrojnë edhe këto funksion. Gjithashtu, koordinatori i programit organizon edhe praktikat profesionale të studentëve. Nga takimi me stafin akademik evidentuam diskutimet në mbledhjen e departamenteve të problematikave lidhur me mësimdhënien, realizimin e praktikave dhe mbrojtjen e diplomave të prezantuara nga përgjegjësi i departamentit</p> <p><i>Evidence nr.1.2.Rregullore e brendshme e UT</i></p> <p><i>Evidence nr.2.39.Vendim për emërimin e koordinatorit të programit</i></p> <p><i>Takim i GVJ me stafin akademik dhe studentët</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se njësia kryesore FE dhe dy njësive bazë DF dhe DK përgjegjëse për këtë program studimit janë të organizuara bazuar në kërkesat e legjislacionit në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, si dhe plotësojnë kërkesat ligjore dhe standardet e kërkuara për këto njësi.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të prezantuar nga FE si njësi kryesore dhe DF dhe DK si njësive bazë të tij si dhe nga verifikimi gjatë vizitës në institucion, rezultoi se këto njësi disponojnë informacionin e nevojshëm mbi organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit dhe jo vetëm si evidencë, por dhe janë të aksesueshme nga gjithë stafi akademik. Ky informacion përfshin të dhëna të plota të programit si dhe gjithë bazën rregullative në nivel institucioni,</p>

<p>dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>fakulteti departamenti dhe programi. Ky informacion është i aksesueshem nëpërmjet faqes se internetit te FE. Gjithashtu UT dhe FE aplikon sistemin e-student nëpërmjet kredencialeve e-albania-s që jep mundësi aksesit në informacion e procesit mësimor.</p> <p><i>Evidenca nr.3.5.Plani mësimor ne vite</i> <i>Evidence 04. Dosja e programit te studimit</i> <i>Evidencë nr.3.5.Programet mësimore të lendeve</i> <i>Evidence nr.1.28. Manual -sistemi e-student</i> <i>Evidence nr.2.7.Guida e studentit, FE</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i programit të studimit vërejmë se ai jep të gjithë informacionin e nevojshëm me elementet përkatës të tij. Programi i studimit organizohet ne gjuhen shqipe dhe angleze i vlerësuar me 180 kredite te cilat janë llogaritur sipas standardeve në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • ore mësimore në auditor leksion, seminar dhe ushtrime; • ore mësimore praktike dhe diplomimi; • ore pune studimi individual jashtë auditorit; <p>Në mbështetje të programit janë edhe rregulloret përkatëse në nivel institucioni fakulteti departamenti si dhe të vete programit. Po ashtu në rregullore të veçanta jepen modalitetet dhe kriteret e regjistrimit të studentëve potencial në këtë program si dhe transferimet nga jashtë apo brenda të studimeve në këtë program.</p> <p><i>Evidencë nr.2.36. Rregullore e programit Bachelor FE</i> <i>Evidencë nr.3.5. Programet mësimore të lendeve</i> <i>Evidencë nr.3.6.Plani mësimor në vite</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Institucioni bazuar në kuadrin ligjor dhe nënligjor ka hartuar bazën rregullatorë lidhur me procesin përcaktimit të kriterëve të përgjithshme apo specifike lidhur me pranimin, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve apo studentëve. Në funksion të këtij procesi është krahas statutit te UT (neni 90,109 dhe 112), rregullorja e brendshme e UT (nenet 78 dhe 80) dhe rregulloret e tjera në nivel njësie kryesore (FE) njësie bazë (DF dhe DK) dhe vete programit te studimit Bachelor. Kriteret e pranimit të kandidateve apo transferimit te tyre shpallen përpara fillimit te regjistrimit si për studentet vendas ashtu edhe për kuotat nga trojet shqiptare Gjatë vizitës në institucion pranë zyrës së</p>

	<p>sekretarisë mësimore, GVJ evidentoi raste transferimi studentësh i bazuar në procedurat e miratuara.</p> <p><i>Evidence nr.1.1.Statuti i UT</i> <i>Evidencë nr.1.2.Rregullore e brendshme e UT</i> <i>Evidence nr.2.16.2.Vendimi i Dekanit mbi kriteret e pranimit</i> <i>Evidencë nr.9.Rregullore e Fakultetit Ekonomik</i> <i>Evidencë nr.2.36. Rregullore e programit Bachelor FE</i> <i>Vizite ne Sekretarinë mësimore të GVJ</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Nga shqyrtimi i programit të studimit rezulton se ai përfshin gjithë elementët përbërës formues teorik praktik për një program të nivelit Bachelor. Nga shqyrtimi i syllabuseve vërehet se ato hartohen në gjuhë shqipe dhe atë angleze dhe përmbajnë të gjithë elementët e përcaktuara në Vendimin e KM Nr.41, datë 24.01.2018, i ndryshuar, si :</p> <ul style="list-style-type: none"> • Emërtimi i lëndës/ modulit; • Viti/ semestri kur zhvillohet lënda; • Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën; • Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit; • Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetimin e lëndës; • Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë; • Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik; • Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS; • Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre; • Format e vlerësimit të studentëve; • Detyrimet e studentit për lëndën; • Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse; <p>GVJ vlerësoi cilësinë e syllabuseve të programit të prezantuar në kuadër të këtij vlerësimi. Hartimi i syllabuseve të programit përfshin të gjitha elementët e nevojshëm duke plotësuar kriteret për to. Format e mësimdhënies janë nëpërmjet vlerësimit periodik në seminare (për pjesëmarrje aktive), detyra kursi, provime të ndërmjetme dhe provim final.</p>

	<p><i>Evidencë nr.2.36. Rregullore e programit Bachelor FE</i></p> <p><i>Evidencë nr.3.5. Programet mësimore të lendeve</i></p> <p><i>Evidencë nr.3.6..Plani mësimor ne vite</i></p>			
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Nga takimi me stafin akademik që mbulon këtë program si dhe me stafin e DF dhe DK u evidentua diskutimi dhe axhustimi programit në mënyre periodike në fillim të vitit brenda lirisë akademike si dhe futjen e informacioneve të reja të njohurive përkatës. Nga ana tjetër, GVJ evidenton që gjatë 3 viteve të fundit nuk janë bërë ndryshime në program qoftë edhe brenda kufirit prej 20 % që është kompetencë e institucionit pa prekur brendinë e programit.</p> <p><i>GVJ mendon që zhvillimet e 4-5 viteve të fundit në ekonomi e bëjnë të domosdoshme përmirësimin e programit në funksion të këtyre ndryshimeve ku me vlerë janë edhe rekomandimet tona të dhëna me sipër.</i></p> <p><i>Evidencë nr.3.5. Programet mësimore të lendeve</i></p> <p><i>Evidencë nr.3.6..Plani mësimor në vite</i></p> <p><i>Vizita ne Institucion e GVJ dhe takim me stafin dhe studentet e programit</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se program i studimit Bachelor në Finance është i detajuar me të gjithë elementet përkatës, si dhe i strukturuar dhe organizuar për të plotësuar objektivat formues të tij.</i></p> <p><i>Përmbajtja e lëndëve/moduleve të programit janë me të gjithë elementet përkatës por edhe në përmbajtjen e tyre duke përbushur objektivat formuese te programi.</i></p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive,	Programi në emërtim dhe përmbajtjen e tij ofron tiparet e një program studimi të nivelit Bachelor në fushën e financës dhe

<p>shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>kontabilitetit. Programi synon të kombinojë njohuritë teorike në këtë fushë me ato praktike. Këtë e shikojmë në përmbajtjen e lëndëve të programit si dhe në realizimin e praktikës profesionale me mundësi punësimi në treg. Emërtimi dhe përmbajtja jo vetëm u mundëson punësimin në përfundim të studimeve në financë, bankë apo kontabilitet, por të diplomuarit në këtë program mund të vazhdojnë ciklin e dytë të studimeve Master në një spektër me të gjerë të financës, riskut, kontabilitetit dhe auditimit.</p> <p><i>Evidencë nr.3.5. Programet mësimore të lendeve</i> <i>Evidencë nr.3.6..Plani mësimor në vite</i></p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të nxënësit.</p>	<p>Programi arrin të pajisë studentët me kompetenca të përgjithshme në të katër drejtimet e tij. Duke analizuar programin shohim që studentët:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në vitin e parë marrin njohuritë bazë makro dhe mikroekonomike, matematike, statistike dhe konceptet në finance të domosdoshme për çdo program të fushës së ekonomisë me një total 57 Kredite; - Në vitin dytë në disa nga lëndët që zhvillohen merren njohuri të fushave bazë të financës dhe kontabilitetit, krahas njohurive në statistikë dhe informatikë me një total 59 kredite; - Në vitin e tretë programi ofron njohuri me specifikë lidhur me financën, bankave, drejtimin financiar, kontabilitet kosto drejtim të cilat krahas praktikës profesionale finalizohen me detyrimet përmbyllëse me një total 64 kredite; <p>Mbështetur në lëndët që ofron programi, por edhe në praktikën profesionale të përfshirë në të, ai arrin të ketë objektiv formimin teorik shkencor dhe relativisht edhe atë aplikativ të studentëve.</p> <p><i>Evidencë nr.3.5. Programet mësimore të lendeve</i> <i>Evidencë nr.3.6..Plani mësimor në vite</i> <i>Vizita ne Institucion e GVJ dhe takim me stafin dhe studentet e programit</i></p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe</p>	<p>Programi në hartimin dhe zhvillimin e tij bazohet në eksperiencë të gjatë të DF dhe DK. Mbështetur në strukturën e programit, në lëndët që përfshihen në të, raportet teorike praktike, ky program përputhet me fushën e zgjedhur që është ajo financiare, bankare dhe kontabile. Në të arrihet të trajtohen</p>

<p>e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>elementët e nevojshëm që lehtësojnë njohjen dhe ekuivalentimin e diplomës jashtë vendit, për qëllim vazhdimin e studimeve në ciklin e dytë apo punësimin e studentit. Programi i studimit është në përputhje me objektivat e përcaktuara në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p> <p><i>Evidencë nr.3.5. Programet mësimore të lendeve</i> <i>Evidencë nr.3.6..Plani mësimor në vite</i> <i>Vizita ne Institucion e GVJ dhe takim me stafin dhe studentet e programit</i></p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit harmonizon përmbajtjen teorike me atë praktike. Nga shqyrtimi i syllabusve të lëndëve karakterizuese të programit shohim që në to një pjesë e temave u referohen rasteve studimore apo praktikave laboratorike. Përmbajtja e tyre është e bazuar në përmbajtjen e lëndëve të tilla edhe në universitetet e huaja duke mundësuar ekuivalentimin në rast transferim studimi. Nga ana tjetër marrëveshjet e shumta qe UT dhe FE kane me institucionet dhe sipërmarrjet private kanë dhënë frytet e tyre ne punësimin e pjesës me te madhe të diplomuarve në këtë program. Është kjo arsyeja qe programi MSH ne Finance zhvillohet ne orarin e pasdites ku pjesa me e madhe e tyre qe kane përfunduar këtë program janë te punësuar.</p> <p><i>Evidencë nr.3.5. Programet mësimore të lendeve</i> <i>Evidencë nr.3.6..Plani mësimor në vite</i> <i>Evidence 3.20.1.Studente të punësuar, Qershor 2025</i> <i>Vizita ne Institucion e GVJ dhe takim me studentet e programit</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i përmbajtjes të lëndëve të këtij programi të prezantuar nga institucione, vërejmë se në to ka përditësim të njohurive bazuar në literaturë detyruese dhe ndihmëse të botuar gjatë viteve të fundit. Edhe nga takimi me stafin e DF, DK dhe atë të programit gjatë vizitës në institucion, ne evidentuam përditësimin e leksioneve të përgatitura nga stafi akademik. Në programet e lëndëve u evidentua që në shumicën e tyre literatura e rekomanduar të jetë e viteve të fundit.</p> <p><i>Evidencë nr.3.5. Programet mësimore të lendeve</i> <i>Evidencë nr.3.6.Plani mësimor në vite</i></p>

	<i>Vizita ne Institucion e GVJ dhe takim me stafin dhe studentet e programit</i>			
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	<p>Përmbajtja e programeve realizon përfitimet e dijeve dhe aftësive të studenteve për një program Bachelor në Finance. Programi i studimit përfshin trajtimin fillimisht të lëndëve bazë me formim mikro dhe makroekonomik dhe që në vitin e parë përfshihen njohurite baze në fushën e financës për tu pasuar në vitet e tjera me lëndë kryesisht profesionale si dhe në fushën e menaxhimit. Programi i studimit kombinon si trajtimin teorik ashtu edhe atë aplikativ sidomos në lëndët e financës dhe kontabilitetit.</p> <p><i>Evidencë nr.3.5. Programet mësimore të lendeve</i> <i>Evidencë nr.3.6.Plani mësimor në vite</i> <i>Vizita ne Institucion e GVJ dhe takim me stafin dhe studentet e programit</i></p>			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	<p>Programi i studimit është mbështetur në eksperiencën e programeve të tilla kombëtare, por edhe në ato ndërkombëtare. Përmbajtja e programit është e tillë që nëpërmjet njohurive të marra në të dy drejtimit e tij (financë dhe kontabilitet) të bëjë të mundur me sukses për studentët e diplomuar vazhdimin e studimeve në ciklin e dytë të programit Master. Gjithashtu, ky program u mundëson hyrjen në tregun e punës të studentëve në këto drejtime. Specifikimi që në emërtim ne finance është përparësi në mundësinë e punësimit të të diplomuarve dhe kjo sidomos në tregun financiar, bankar dhe atë kontabël.</p> <p><i>Evidencë nr.3.5. Programet mësimore të lendeve</i> <i>Evidencë nr.3.6..Plani mësimor në vite</i> <i>Evidence 3.20.1.Studente të punësuar, Qershor 2025</i></p>			
Konkluzione	<i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se program i studimit Bachelor në Financë përmbush objektivat formuese të tij dhe nivelin kualifikues sipas Kuadrit Kombëtar dhe European të Kualifikimeve duke mundësuar studentët e diplomuar për tu punësuar në tregun financiar, bankar dhe atë kontabël.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5	
Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>FE si njësi kryesore dhe DF dhe DK si njësite bazë dhe përgjegjëse të këtij programi bazuar në rregulloren e programit dhe marrëveshjet institucionale me aktorët e tregut të punës analizojnë periodikisht mundësitë e përmirësimit të programeve ku ajo është përgjegjëse drejtpërdrejt.</p> <p>Janë 45 marrëveshje mes FE dhe institucioneve të ndryshme përfshirë dhe institucione financiare dhe bankare audituese apo sipërmarrjeve private brenda vendit ku për një pjesë të tyre përfshihen edhe veprimtari të përbashkëta kërkimore apo kurse trajnimi. Nga takimi me stafin akademik të programit evidentuam ndryshime në përmbajtjen lëndore në syllabuse në kuadër të lirisë akademike.</p> <p>Gjithashtu, nga diskutimi me stafin akademik që zhvillon këtë program, evidentuam përmirësim në ciklet e leksioneve të lëndëve që ata mbulojnë kryesisht me trajtime aplikative të lidhura me drejtimin financiar dhe kontabilitetin. Angazhim në këtë program i një numri PAK që punojnë pranë sipërmarrjeve apo institucioneve të ndryshme është një nga faktorët që kanë bere te mundur edhe diskutimin e risive ne fushën e financës dhe kontabilitetit te lidhura me tregun e punës.</p> <p><i>Evidence nr.2.21.Marreveshjet ndërinstitutionale</i></p> <p><i>Evidence nr.2.22.Linqe për workshop, leksione të hapura dhe aktivite te tjera</i></p> <p><i>Vizita ne Institucion e GVJ dhe takim me stafin dhe studentet e programit</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni zbaton kërkesat ligjore dhe nënligjore lidhur me përfaqësimin e studenteve ne strukturat udhëheqëse dhe monitoruese si Senat, Këshillin e Etikes, komisionin për Sigurimin e Cilësisë, NJSBC dhe anëtarë ne GVB te raportit përkatës te këtij programi. Bazuar në vizitën pranë FE, DF dhe DK si dhe nga takimi me pjesëtarët e degës se Ekselencës dhe Këshillimit te Karrieres dhe me pas me studentët e programit, si edhe nga udhëzuesi i kësaj zyre, rezulton se institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar.</p>

	<p>Po ashtu edhe DF dhe DK zhvillojnë diskutime me studentë të këtij programi mbi përmirësime të mundshme në program. Në funksion të këtij qëllimi realizohet dhe pyetësori për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies nga studentët, por GVJ nuk evidentoi në raportin mbi anketimin të hartuar nga NJSBC propozime nga studentët për përmirësime në programin e lëndëve.</p> <p><i>Evidence nr.1.17.Manuali i Cilësisë UT</i> <i>Evidence nr.2.10.1.Raporte te NJSBC</i> <i>Vizita ne Institucion e GVJ dhe takim me stafin dhe studentet e programit</i></p>			
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>DF dhe DK mbajnë kontakte periodike me studentët e programit, Zyrën e Këshillimit dhe Karrierës në funksion të përmirësimit të programit dhe qasjes së tij me tregun e punës. GVJ e evidentoi këtë proces gjatë takimit me stafin dhe studentet e programit. Në funksion të këtij qëllimi njësia bazë organizojnë leksione të hapura dhe workshop-e të përbashkëta me stafin dhe studenteve nga njëra anë dhe përfaqësuesve të institucioneve dhe sipërmarrjeve private me tema me synimin nxitjen e diskutimeve dhe problematikave të zhvillimit në finance dhe kontabilitet. Gjatë 3 viteve të fundit janë organizuar 13 workshope ku mund të veçonim :</p> <ul style="list-style-type: none"> • workshop mbi sfidat dhe zhvillimi i kurrikulës universitare dhe profesionale të kontabilitetit në sektorin publik;; • workshop mbi Teknologjinë digjitale dhe etika në fushën e kontabilitetit dhe auditimit; <p><i>Evidence nr.3.11.1.Analize vjetore e Departamentit</i> <i>Evidence nr.2.22.Linqe për workshop, leksione te hapura dhe aktivite te tjera</i> <i>Evidenca 1.21 Vlerësimi i lendes nga studentet</i> <i>Vizita e GVJ në institucion; Takim me studentet dhe Zyrën e Këshillimit të Karrierës.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ evidenton përkushtim të FE dhe DFK në përfshirjen e studentëve dhe aktorëve të tjerë institucional dhe sipërmarrjes private në përmirësimin e programit të studimit me qëllim përmirësim të mundshëm të programit në funksion të nevojave të tregut të punës në finance dhe kontabilitet.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

				X
--	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
<p>Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Mësimdhënia në programin Bachelor në “Finance” bazohet në kuadrin rregullator në nivel institucional, njësie kryesore dhe njësie bazë. Në funksion të këtij procesi janë përkatësisht rregullorja e studimeve në UT; rregullorja e FE, dhe vetë rregullorja e programit të studimit Bachelor në FE në të cilat përcakton format e mësimdhënies dhe vlerësimin e dijeve të studentëve. Procesi mësimor zhvillohet nëpërmjet formave të mirënjohura: leksione, seminare, detyra kursi, ushtrime, praktika profesionale etj, të organizuara në 31 lëndë, ku janë parashikuar teste të ndërmjetme, detyra kursi, provim përfundimtar dhe tema e diplomës në përmblyllje të studimeve. Në planin mësimor orët mësimore në auditor dhe jashtë auditorit si angazhim individual i studentit janë të përcaktuar sipas të gjitha elementëve të një programi të nivelit Bachelor dhe brenda standardeve për te njohur numrin e krediteve.</p> <p>Në këtë program lëndët zhvillohen sipas syllabusit përkatës dhe në liri të plotë të personelit akademik. Për të ruajtur objektivitetin e vlerësimit, forma e kontrollit në program është me shkrim dhe e sekretuar. Në politikën e Institucionit është praktikë që nota e studentit të jetë e “ndërtuar”, që do të thotë që studentit testohet gjatë semestrit në secilën lëndë përveç provimit përfundimtar në sezon. Shumatorja e pikëve të mbledhura përbën vlerësimin e tij përfundimtar. Forma e vlerësimit referuar ECTS përcaktohen me notë 1 deri 10. Ky sistem vlerësimi përfshin 100 pikë, të cilat përgjithësisht janë të ndara në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • frekuentimi dhe vlerësimi gjatë semestrit;

	<ul style="list-style-type: none"> • testi i ndërmjetëm apo detyra e kursit që zhvillohet në mes të semestrit; • provimi përfundimtar që zhvillohet në fund të semestrit; <p>Mënyra e vlerësimit të studentëve është prezantuar në syllabusin e çdo lënde dhe ne evidentuam që vlerësimi i vazhduar është deri në nivelin e 40 % të pikëve totale. Bazuar në dokumentacionin e aplikimit pranë ASCAL-it si dhe nga takimi me stafin dhe studentet e programit evidentuam realizimin gjate viteve të zhvillimit të programit të leksioneve të hapura me personalitete apo profesioniste të fushës së financës dhe kontabilitetit.</p> <p><i>Evidenca nr.3.5.Plani mësimor në vite</i> <i>Evidence 04. Dosja e programit të studimit</i> <i>Evidencë nr.3.5.Programet mësimore të lendeve</i> <i>Vizita në institucion: Takim me stafin akademik dhe studentët</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Personeli akademik që mbulon këtë program ka aftësitë pedagogjike bashkëkohore në mësimdhënie rrjedhojë kjo edhe e eksperiencës relativisht të gjatë në procesin e mësimdhënies. Pozitive është fakti që stafi i programit ka realizuar mobilitete të ndryshme në kuadër të projekteve të institucionit, Bazuar në evidencat përkatëse rezulton se gjate tre viteve te fundit ne kuadër te projektit ERASMU-s për stafin dhe studentet e këtij programi janë realizuar mobilitetet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 21 anëtarë të stafit akademik kane realizuar mobilitete jashtë vendit në universitete partnere në mësimdhënie dhe trajnime, • 22 staf akademik i huaj kanë realizuar mobilitete pranë FE dhe DF dhe DK ne mësimdhënie dhe trajnime; <p>Këto mobilitete janë më të shumta në numër po ti referohemi si njësi kryesore (FE). GVJ evidentoi faktin e realizimit te trajnimeve të stafit të ri akademik pranë Qendrës të zhvillimit Profesional dhe Trajnimit te UT si një forme efektive për përmirësimin metodologjik dhe pedagogjik te stafit. Në kuadër te përmirësimit të procesit të mësimdhënies me efektivitet janë edhe realizimi i më shumë seanca praktike të mësim nxënies në lëndët aplikative sidomos ne kontabilitet.</p> <p><i>Evidenca nr.3.10. Lista e mobiliteteve për Personelin Akademik dhe Studente qe ndjekin programin Bachelor në Financë.</i> <i>Evidence 1.38. Vendim për ngritjen e Qendrës Virtuale te Zhvillimit</i></p>

	<p><i>Profesional dhe Trajnimit në UT.</i></p> <p><i>Evidence 04. Dosja e programit te studimit</i></p> <p><i>Evidence 03. Tabelat përmbledhëse Aneks (tabela nr.20)</i></p> <p><i>Vizita në institucion: Takim me stafin akademik</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Bazuar në takimin me stafin e DF dhe DK rezultojnë se UT mbështet stafin akademik në përmirësimin e metodës pedagogjike kryesisht nëpërmjet vizitave pranë universiteteve homologe të huaja, mobiliteteve në kuadër të projektit ERASMUS+ si dhe nëpërmjet aktivitete të organizuara me partnere vendas dhe të huaj në shërbim të këtij qëllimi.</p> <p>Institucioni UT dhe njësi kryesore FE kanë qenë aktive në realizimin e workshopeve me objekt përmirësimin e metodave të mësimdhënies dhe mesimnxënies në bashkëpunim si me institucionet homologe ashtu edhe në kuadër të programit READ të financuar nga AADF pranë FE. Edhe një pjesë e leksioneve të hapura kanë qenë në kuadër të këtij qëllimi.</p> <p>Në kuadër edhe të zhvillimeve të viteve të fundit stafi akademik ka përdorur edhe platformat e njohura të mësimdhënies online si e-learning Microsoft Teams apo Google Classroom të cilat ishin dhe metoda kryesore gjatë periudhës së pandemisë COVID 19.</p> <p><i>Evidenca nr.3.10. Lista e mobiliteteve për Personelin Akademik dhe Studente që ndjekin programin Bachelor në Financë.</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.5.Plani mësimor në vite</i></p> <p><i>Evidence 04. Dosja e programit te studimit</i></p> <p><i>Evidence 03. Tabelat përmbledhëse Aneks (tabela nr.20)</i></p> <p><i>Evidence 1.38. Vendim për ngritjen e Qendrës Virtuale të Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit në UT.</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit të student mendimin krijues, atë kritik si dhe</p>	<p>Personeli akademik që mbulon këtë program ka eksperiencën dhe kualifikimin e duhur akademike dhe pedagogjike për një proces mësimdhënie të suksesshëm. Bazuar në CV-të e stafit akademik, vëmë re që pothuajse të gjithë kanë një formim akademik dhe profesional në fushën e financës kontabilitetit dhe menaxhimit në përputhje me lëndët që karakterizojnë drejtimet përkatëse.</p> <p>Nga takimi me studentët e programit u evidentua një bashkëpunim reciprok i frytshëm mes tyre dhe personelit akademik. Është praktikë e procesit mësimor që në fund të zhvillimit të lëndës si dhe para se vlerësimi i lëndës të gjenerohet në sistem realizohet një takim mes pedagogut dhe studentëve. Nga takimi me studentet u evidentua se stafi</p>

<p>autonominë e përgjegjshmërinë</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>akademik ishte i hapur për diskutime rreth problematikes se mësimdhënies dhe mesimnxenies ne funksion te realizimit me sukses te programit te studimit. Të dyja njësitë bazë DF dhe DK kane organizuar edhe aktivitete te vecanta me studentet e programit ne funksion te këtij objektivi</p> <p><i>Evidence nr.3.12. CV e stafit akademik PAE dhe PAK</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.10. Lista e mobiliteteve për Personelin Akademik dhe Studente që ndjekin programin Bachelor në Financë.</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.5.Plani mësimor ne vite</i></p> <p><i>Evidence 04. Dosja e programit të studimit</i></p> <p><i>Evidence 03. Tabelat përmbledhëse Aneks (tabela nr.20 dhe 22)</i></p> <p><i>Vizita në institucion: Takim me stafin akademik dhe studentet</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>DF dhe DK si një njësi bazë te konsoliduar tashme prej shume vitesh luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e programit të studimit. Kjo realizohet nëpërmjet mobiliteteve per studentet, zhvillimin e leksioneve te hapura me ta, të workshopeve per tema te caktuara dhe konsultimi periodik me ta. Vetëm gjate tre viteve te fundit janë 12 studente te këtij programi qe kane realizuar mobilitete ne universitetet partnere të huaja.</p> <p>Nga ana tjetër është bërë e mundur përfshirja e studentëve në vlerësimin e mësimdhënies dhe stafit akademik. Krahas përvojës mësimdhënëse që stafi i programit ka marrë nëpërmjet mobiliteteve të programit ERASMUS+, në UT janë realizuar edhe trajnime pedagogjike me stafin e ri akademik. Në funksion të këtij qëllimi realizohet dhe pyetësori për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies nga studentët.</p> <p><i>Evidenca nr.3.10. Lista e mobiliteteve për Personelin Akademik dhe Studente qe ndjekin programin Bachelor në Financë.</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.5.Plani mësimor në vite</i></p> <p><i>Evidence 04. Dosja e programit të studimit</i></p> <p><i>Evidence 03. Tabelat përmbledhëse Aneks (tabela nr.20 dhe 22)</i></p> <p><i>Evidenca 1.22.Vleresim i lendes nga studenti</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies,</p>	<p>UT krahas akteve ligjore dhe rregullatorë, në funksion të procesit mësimor shkencor institucioni ka të ngritura strukturat që monitorojnë, vlerësojnë dhe përmirësojnë procesin mësimor shkencor. Krahas Komisionin te Përhershëm te Sigurimit de Standardeve të Cilësisë (KPSSC) dhe NJSBC ne nivel institucioni, me vendim Dekanati nr.65 date 28.09.2021 është</p>

<p>koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimin të metodave të reja.</p>	<p>ngritur dhe NJSBC ne nivel te njësisë kryesore FE si struktura kryesore te këtij procesi.</p> <p>Në këtë njësi është anëtar edhe përfaqësues nga studentet. NJSBC, funksionon në bazë të rregullores përkatëse të saj. Në këtë rregullore sanksionohen funksionet dhe mënyra e operimit të kësaj njësie. Nga shqyrtimi i raporteve të NJSBC mbi organizimin e pyetësorëve me studentët vërehet një pjesëmarrje relativisht e ulët e tyre në këtë proces (për këtë program studimi). Në takimin me studentët e programit ata prezantuan edhe sugjerimin që kishin bërë në takimet me pedagogun e lëndës kryesisht për rritjen e trajtimeve me karakter praktik dhe aplikativ të cilat ishin marrë në konsideratë nga pedagogët përkatës të lëndëve.</p> <p><i>Evidenca 1.22.Vleresim i lendes nga studenti</i> <i>Evidenca nr.1.14Rregullore për sigurimin e cilësisë</i> <i>Evidenca nr1.17. Manuali i cilësisë ne UT</i> <i>Evidenca 1.21.Paketa e instrumenteve te cilësisë</i> <i>Takimi me studentet gjate vizitës në institucion.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se UT dhe njësia kryesore FE dhe ajo bazë DF dhe DK realizojnë në procesin mësimor gjithë elementet e duhur te mësimdhënies të ndara në leksione ,seminare ,projekte e detyra kursi, praktikë profesionale, pune e pavarur jashtë auditorit etj.</i></p> <p><i>Institucioni në përmbushje të akteve ligjore dhe nënligjore ka ngritur strukturat përkatëse që promovojnë vlerësojnë dhe mbikëqyrin përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë të mësimdhënies.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi III.2</p>	
<p>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive,</p>	<p>Kriteret dhe mënyra e testimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara qartë në rregulloret e posaçme, të cilat janë pjesë zbatuese si në nivelin institucional</p>

<p>dijeve dhe aftësiwe profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>(Rregullore e UT), rregulloren e këtij programi si dhe në manualin e zhvillimit të provimit. Këto dokumente janë të publikuara dhe studentët kanë akses në to. Më të specifikuara mënyrat e testimit jepen në syllabuset e lëndëve përkatëse ku përgjithësisht vlerësimi i vazhduar dhe ai përfundimtar janë në raportin 20% - 30% me 70 % - 80%.</p> <p><i>Evidence nr.1.2. Rregullore e UT</i> <i>Evidence nr.2.36. Rregullore e programit Bachelor në FE.</i> <i>Evidencë nr.3.5.Programet mësimore të lendeve</i> <i>Evidence nr.3.3. dhe 33.1.Manuali i zhvillimit te provimeve të DF dhe DK</i></p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësiwe profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e ofruar dhe vizitën në institucion, GVJ evidenton se studentët e programit informohen mbi mënyrën e vlerësimit të njohurive nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Informacionit të marrë në webin e institucionit pasi rregulloret në këtë drejtim janë të përfshira në të; • Informacionit që marrin që në fillim të semestrit përkatës nëpërmjet syllabuseve të lëndëve përkatëse të pedagogëve përgjegjës për zhvillimin e tyre; <p>Bazuar në syllabusin e pedagogëve të programit të studimit Bachelor në “Financë” dhe vizitës në institucion, u konstatua se pedagogu i secilës lëndë, javën a parë të mësimit bën prezantimin e përmbajtjes së lëndës, objektivat, temat e lëndës si dhe elementët e tjerë të syllabusit.</p> <p><i>Evidence nr.1.2. Rregullore e UT</i> <i>Evidence nr.2.36. Rregullore e programit Bachelor në FE.</i> <i>Evidencë nr.3.5.Programet mësimore të lendeve</i> <i>Takimi me stafin akademik dhe studentet gjate vizitës në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësiwe profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Vlerësimi i njohurive të studentëve realizohet në format tashmë të konsoliduar dhe përfshijnë elementë të vlerësimit të vazhdueshëm në seminar, testimin e ndërmjetëm, detyrat e kursit, provimin përfundimtar etj, elementë këto që u evidentuan të përcaktuara në syllabuse në kriteret standarde.</p> <p><i>Evidence nr.1.2. Rregullore e UT</i> <i>Evidence nr.2.36. Rregullore e programit Bachelor në FE.</i> <i>Evidencë nr.3.5.Programet mesimore te lendeve</i></p>

<p>Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Mendimi i studentëve për cilësinë e mësimdhënies dhe vlerësimi i tyre për performancën e pedagogut realizohet nëpërmjet organizimit nga Dega e Sigurimit të Cilësisë e cila shpërndan pyetësorët dhe mbledh te dhënat. Ky anketim realizohet në fund të çdo semestri para provimit në formën online. Me pas këto te dhëna i dërgohen NJSBC së FE e cila harton raportin përkatës. Raporti i rezultateve të dala hartohet nga kjo njësi dhe analizohet në DF dhe DK si njësi bazë e këtij program studimi. Nga ana tjetër, edhe vetë njësite bazë organizojnë kontrolle dhe monitorim te procesit mësimor. Ne raportin e fundit të NJSBC përqindja e studenteve të këtij programi që i janë përgjigjur pyetësorit është rreth 31 %.</p> <p><i>Evidence nr.1.2. Rregullore e UT</i> <i>Evidence nr.2.36. Rregullore e programit Bachelor në FE.</i> <i>Evidenca 2.10.1. Raporte të NJSBC</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Nga takimi me stafin akademik dhe studentët e programit u evidentua që realizimi i procesit mësimor nëpërmjet metodave të mirënjohura kombinohet me një qasje interaktive mes tyre duke nxitur diskutimet në grupin e tyre. Kjo realizohet edhe gjatë prezantimit të detyrave të kursit duke krijuar një ambient bashkëpunues. Grupi i studentëve në takim vlerësonte maksimalisht formën e diskutimit me grupin e tyre gjatë zhvillimit të mësimit. Niveli i lartë i notes mesatare ne hyrje te studenteve te këtij programi është edhe një faktor që ka nxitur këtë marrëdhënie interaktive mes pedagogut dhe studentit.</p> <p>Në funksion të këtij qëllimi janë edhe përdorimi i sistemit informatikë Microsoft Teams ku studentet marrin informacionin e kërkuar. GVJ evidentoi dhe aktivitete në funksion të këtij qëllimi siç ishte pjesëmarrja e studentëve të këtij programi në lenden e Sisteme te Kompjuterizuara ne Kontabilitet ku aplikohen programet kontabile te njohura dhe përdorura ne vendin tone.</p> <p><i>Evidence nr.1.2. Rregullore e UT</i> <i>Evidence nr.2.36. Rregullore e programit Bachelor në FE.</i> <i>Evidence nr. 3.21. Marrëveshje bashkëpunimi me Bilanc Shpk.</i> <i>Takimi me studentet gjate vizitës në institucion.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se ky i fundit ka të plotë kuadrin rregullator, mbikëqyrës dhe procedural të vlerësimit të dijeve të studentëve gjatë procesit mësimor.</p>

	<i>Institucioni garanton realizimin e drejtë, vlerësimin e saktë të dijeve dhe aftësitë profesionale në procesin e mësimdhënies dhe mësim nxënies.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Vlerësimi i njohurive të studentëve bazohet në praktikat më të mira të përdorura në IAL. GVJ, gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, evidentoi praktika vlerësimi të semestrit të parë të këtij programi, në disa nga lëndët për të cilat ishte përmblytur vlerësimi. Njohuritë e marra gjatë zhvillimit të këtyre lëndëve në semestrin përkatës vlerësohen përgjithësisht 30% të notës përfundimtare (angazhim në seminar dhe detyra/projektet e kursit si dhe testi i ndërmjetëm), ndërsa provimi përfundimtar zë rreth 70 % të vlerësimit, duke reflektuar kështu edhe përcaktimin e këtij vlerësimi sipas syllabusit. Procesi i realizimit të vlerësimit është trajtuar edhe në rregulloren e programit dhe përfshin edhe aspekte të tjera të tij si sekretimin, kohën e shpalljes së rezultateve , ankimimin e studentët etj.</p> <p>UT dhe FE ka aplikuar për studentët e programit Bachelor në FK platformën e-student si një mjet transparent komunikimi dhe informacioni mes pedagogut dhe studentit. GVJ evidentoi dhe zhvillimin online të procesit mësimor gjatë periudhës së pandemisë e paraprirë me rregulloren përkatëse dhe platformat e përdorura në këtë proces.</p> <p><i>Evidence nr.1.2. Rregullore e UT</i> <i>Evidence nr.2.36. Rregullore e programit Bachelor në FE.</i> <i>Evidencë nr.3.5. Programet mësimore të lendeve</i> <i>Takim gjate vizitës në institucion me stafin, studentet dhe sekretarinë mësimore.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat</p>	<p>Vlerësimet e lëndëve të programit realizohen me shkrim dhe një pjese e tyre me sistemin e automatizuar në kuadër të projektit Clean Score në bazë të modelit të aprovuar të tezës së provimit. Institucioni në të tre nivelet e tij ka rregulloret</p>

<p>shmingjin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>përkatëse lidhur me format e zhvillimit të provimit ashtu edhe udhëzime për këtë proces. Ne funksion te këtij procesi është dhe manuali i zhvillimit te provimeve te departamenteve</p> <p>Vlerësimi përfundimtar hidhet ne platformën e-student si një mjet transparent komunikimi dhe informacioni mes pedagogut dhe studentit. Pedagogu përpara se te gjenerojë përfundimisht procesverbalin e vlerësimit organizon një takim me studentet nëse ka reklamim apo sqarim te mundshëm. Kjo u konfirmua dhe ne takimin me studentet.</p> <p><i>Evidence nr.1.2. Rregullore e UT</i></p> <p><i>Evidence nr.2.36. Rregullore e programit Bachelor në FE.</i></p> <p><i>Evidencë nr.3.5. Programet mësimore të lendeve</i></p> <p><i>Evidence nr.3.3.1. Manual i zhvillimit të provimeve të departamenteve</i></p> <p><i>Evidence nr.3.15. Model flete provimi me Clean Score</i></p> <p><i>Takim gjate vizitës në institucion me stafin, studentet dhe sekretarinë mësimore.</i></p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Për realizimin e vlerësimin përfundimtar të dijeve të studentëve, DF dhe DK, bazuar në rregulloret përkatëse në nivel institucional dhe të vetë këtij programi (neni 25 dhe 26 faqe 12), në bashkëpunim me sekretarinë mësimore, miratojnë komisionet e provimit me një numër anëtarësh stafi jo më pak se 2, ku njëri është titullari i lëndës dhe tjetri është pedagog i fushës përkatëse. GVJ evidentoi nënshkrimin e anëtarëve të komisionit në procesverbalet e provimeve të lëndëve, si dhe praktikave profesionale të firmosura nga 2 anëtarët e komisionit të provimit dhe Përgjegjësi i DF dhe DK.</p> <p><i>Evidence nr.2.36. Rregullore e programit Bachelor në FE.</i></p> <p><i>Evidencë nr.3.5. Programet mësimore të lendeve</i></p> <p><i>Evidence nr.3.3.1. Manual i zhvillimit te provimeve të departamenteve</i></p> <p><i>Takim gjate vizitës në institucion me stafin, studentet dhe sekretarinë mësimore.</i></p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi</p>	<p>Zhvillimi i testimit të vlerësimit bazohet në anonimitetin dhe monitorim nga DF dhe DK. Kushtet e zhvillimit të provimit janë optimale dhe hapësirat ndërmjet studentëve në këtë proces janë të përshtatshme. Në raste zhvillimit të testimit në laborator shtohet dhe personel mbikëqyrës gjatë zhvillimit të provimit. Format i tezës së provimit ka si seksion më vete komentet e pedagogut për përgjigjet e studentit për pyetjet që kërkojnë</p>

<p>procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>qëndrim/opinion të studentit. Në fund të tezës është vlerësimi i detajuar sipas pyetjeve teorike dhe ushtrimeve.</p> <p><i>Evidence nr.2.36. Rregullore e programit Bachelor në FE.</i></p> <p><i>Evidence nr.3.3.1. Manual i zhvillimit të provimeve të departamenteve</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Bazuar në kuadrin e brendshëm rregullator (neni 27 i rregullores së programit Bachelor) si dhe nga takimi me stafin akademik dhe studentët e programit evidentohet korrektësia e zhvillimi të provimit si me monitorimin nga dy pedagogë anëtarë të komisionit ashtu edhe moslejimi i përdorimit të celularëve apo formave të tjera të kopjimit. Mos lejimi i plagjiaturës apo kopjimi gjatë provimit janë të sanksionuar në rregulloren e UT dhe vete programit.</p> <p><i>Evidence nr.2.36. Rregullore e programit Bachelor në FE.</i></p> <p><i>Evidence nr.3.3.1. Manual i zhvillimit të provimeve të departamenteve</i></p> <p><i>Evidence nr.1.5. Kodi i Etikës i UT</i></p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin përkatës por edhe gjatë takimeve me stafin akademik dhe studentët evidentohet se vlerësimi i dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën, ku pedagogu krahas realizimit të sekretimit të tezave shpall rezultatet e vlerësimit brenda kohës së parashikuar sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. Dorëzimi i vlerësimeve të provimeve bëhet brenda 7-10 ditëve nga data e zhvillimit të tyre brenda të cilave përfshihen edhe seancat sqaruese (nga takimi me stafin akademik). Vlerësimi për komponentët e tjerë duhet të dorëzohen përpara zhvillimit të provimit përfundimtar dhe pedagogu nuk ka të drejtë të ndërhyjë për ndryshim pas zbardhjes së rezultateve të provimeve. Një ndihmese në këtë komunikim mes pedagogut dhe studenteve jep platforme <i>e-student</i></p> <p>GVJ evidentoi dhe një simulim konkret të hedhjes së pikëve të vlerësimit të vazhduar dhe përfundimtar të studentëve në platformën përkatëse.</p> <p><i>Evidence nr.2.36. Rregullore e programit Bachelor në FE.</i></p> <p><i>Evidence nr.3.3.1. Manual i zhvillimit të provimeve të departamenteve</i></p> <p><i>Evidence nr.1.5. Kodi i Etikës i UT</i></p>

	<i>Vizita në institucion e GVJ me stafin akademik, studentet dhe pranë sekretarisë mësimore)</i>			
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p> <p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Bazuar në rregulloret përkatëse të studimit, studenti ka 2 ditë kohë pas shpalljes së rezultatit të vlerësimit që të bëjë ankesë nëse ai ka pretendime për një vlerësim më të lartë. Institucioni ka model formulari tip për ankimimin e studentit. Atij i jepet mundësia të ballafaqohet me pedagogun e lëndës dhe vlerësimin e bërë si dhe i jepet përgjigja edhe e shkruar në formular. Nga takimi me studentët e këtij programi gjatë vizitës në institucion ata nuk kishin pasur praktikë të tillë. Reklamimi për vlerësimin nuk kishte shkuar në këtë fazë pasi ishte zgjidhur gjatë takimit që pedagogu i lëndës zhvillon me studentët në datën e paracaktuar para se të hedhë vlerësimet përfundimisht në sistem.</p> <p>Në rast të kërkesës për ankimim që bën student sipas formularit të miratuar pasi është ezauruar takimi me pedagogun e lëndës Dekani në bashkëpunim me përgjegjësin e DFK ngre një komision ad-hok për rivlerësim të provimit. Në përfundim të vlerësimit Komisioni jep vendimin final duke e bërë transparente procesin me studentin dhe pedagogun e lëndës përkatëse. Për këtë program ne nuk evidentuam një realizim praktike të tilla.</p> <p><i>Evidence nr.2.36. Rregullore e programit Bachelor në FE.</i></p> <p><i>Evidence nr.3.3.1. Manual i zhvillimit të provimeve të departamenteve</i></p> <p><i>Evidence nr.1.5. Kodi i Etikes i UT</i></p> <p><i>Vizita në institucion e GVJ me stafin akademik, studentet dhe pranë sekretarisë mësimore)</i></p>			
Konkluzione	GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se arrihet një vlerësim i drejtë i dijeve të studentëve duke respektuar konfidencialitetin, paanësinë dhe të drejtën e ankimimit nga studentët dhe zgjidhjes së saj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Programi arrin të pajisë studentët me kompetenca të përgjithshme kryesisht në fushën e financës dhe kontabilitetit, por edhe të menaxhimit. Programi synon që të rrisë edhe kompetencat profesionale të studentëve me fokus rritjen e aftësive praktike në këto drejtime. Mbështetur në 31 lendet që ofron programi, por edhe në praktikën profesionale të përfshirë në të, ai arrin të ketë objektiv formimin teorik dhe relativisht edhe atë profesional të studentëve. Në këtë kuadër praktika profesionale dhe përgatitja e diplomës që synohet të jetë aplikative, i shërbejnë këtij objektiv dhe rrisin më shumë përgatitjen profesionale të studentëve.</p> <p><i>Evidenca nr.3.5.Programet mësimore të lendeve</i> <i>Evidence nr.3.6.Plani mësimor në vite</i> <i>Evidence nr.19.Plani strategjik i programit të studimit</i> <i>Evidence 04. Dosja e programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>Bazuar në programin mësimor, ky program studimi garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë dhe informacionit si dhe shkencat humane. Në programin e studimit përfshihen lëndë të kësaj natyre si “Informatikë” “Hyrje ne Modelim Financiar” dhe “Statistike e zbatuar” qe zhvillohen ne vitin e dyte dhe lenden “Sisteme te Kompjuterizuara ne Kontabilitet” që zhvillohen në vitin e tretë dhe që është pjesë e fushës së këtij programi.</p> <p>Nga takimi me stafin dhe studentët rezultoi që aftësitë e veçanta në fushën e informacionit e teknologjisë arrihen edhe nëpërmjet trajtimin e rasteve studimore, apo detyrave të kursit si dhe tema të caktuara që zhvillohen në laborator. Gjatë periudhës së pandemisë COVID-19 mësimi është realizuar përmes platformave të mirënjohura tashmë si Google classroom, sistemi Tims etj. Për mbarëvajtjen e procesit mësimor në këtë periudhë institucioni hartoi dhe udhëzime dhe rregullore përkatëse.</p> <p><i>Evidenca nr.3.5.Programet mësimore të lendeve</i> <i>Evidence nr.3.6.Plani mësimor në vite</i> <i>Evidence nr.19.Plani strategjik i programit të studimit</i></p>

<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Nga takimi me stafin e programit dhe studentët, GVJ evidentoi që në orën e fundit të leksionit bashkëbisedojë mes pedagogut dhe studentit mbi realizimin e programit të lëndës bazuar në syllabusin e paraqitur që në fillim të semestrit si dhe orientoheshin këta të fundit për provimin final.</p> <p><i>Evidenca nr.3.5.Programet mësimore të lendeve</i> <i>Evidence nr.3.6.Plani mësimor në vite</i> <i>Evidentim nga vizita në institucion dhe takimi me stafin akademik dhe studentet.</i></p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuar kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionit dhe takimin e zhvilluar me stafin e programit të studimit dhe studentët e këtij programi konstatohet që pedagogë që mbulojnë lëndë te ndryshme e realizonin zhvillimin e programit në tema të caktuara nëpërmjet punëve laboratorike. Në disa raste përgatitja dhe mbrojtja e detyrës së kursit bëhet në laboratorin e informatikës. Një rol të rëndësishëm në formimin profesional të studentëve luan edhe realizimi i praktikës profesionale e cila është mundësuar në drejtimet kryesore që ofron ky program dhe që orientohet nga paketa e praktikës për programin Bachelor. Institucioni ka të aprovuar dokumentacionin përkatës të praktikës profesionale. Në këtë dokument jepen gjithë modalitetet e realizimit të këtij komponenti të rëndësishëm të programit , si dhe vlerësimi nga studenti i këtij komponenti. Lënda “Sisteme te Kompjuterizuara ne Kontabilitet” si një lende e fushës zhvillohet e gjitha në laborator për vetë specifikën praktike te saj.</p> <p><i>Evidenca nr.3.5.Programet mësimore të lendeve</i> <i>Evidence nr.3.6.Plani mësimor në vite</i> <i>Evidence nr.19.Plani strategjik i programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë</p>	<p>Institucioni në mënyrë aktive realizon aktivitete në formën e takimeve, leksioneve të hapura me pjesëmarrjen e profesionisteve të fushave përkatëse. Në rang njësie bazë, në evidentuam kalendarin e aktiviteteve të DF dhe DK ku pjesëtarë të stafit akademik parashikonin të realizonin takime trajnimi me studentët dhe profesioniste jashtë institucionit. Në</p>

brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	<p>dokumentacionin e aplikimit prezantohet edhe raporti i aktiviteteve dhe trajnimeve profesionale që janë organizuar në institucion. Bazuar në dokumentacionin e aplikimit pranë ASCAL-it evidentohen se gjatë periudhës 2022-2024 janë realizuar një numër takime trajnimi dhe leksione të hapura me personalitete të njohura të fushës së ekonomisë dhe financës.</p> <p><i>Evidenca nr.2.25. Aktivitet Njoftim Zyra e Karrierës FE te UT</i> <i>Evidenca nr.2.22.Linque për Worksho-e, leksione te hapura</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar në institucion konkludon se programi i studimit Bachelor në Financë arrin të përmbushë objektivat e tij duke pajisur studentët me njohuri teorike praktike dhe me aftësi profesionale në fushën e financës, bankës, kontabilitetit dhe auditimit.</i></p> <p><i>Përmbajtja e këtij programi u jep mundësi të diplomuarve të kenë një spektër të gjerë punësimi në tregun e punës në sektorin e financës dhe të kontabilitetit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<p>Studentët e këtij programi, pas përmbylljes së gjithë detyrimeve, kanë të drejtën e përmbylljes së detyrimeve kryesisht përmes mbrojtjes së një punimi diplome. Kriter për mënyrën e vlerësimit të përmbylljes së programit të studimit është nota mesatare e studentit e cila propozohet çdo vit nga DF dhe DK. Procedura e mbrojtjes përfundimtare, kriteret e mbrojtjes me provim final apo punim diplome janë të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit Bachelor(Kreu V neni 36, 37 dhe 38), si dhe në vetë rregulloren e UT. Ky proces është me i detajuar në udhëzuesin e mbrojtjes së diplomës Bachelor ne Finance si një dokument më vete (pike I dhe II). Të gjitha procedurat e posaçme lidhur me mbrojtjen e diplomës hartohen nga institucioni dhe bëhen publike për të gjithë studentët.</p>




	<p><i>Evidenca nr.1.2. Rregullore e UT</i></p> <p><i>Evidenca nr.2.36. Rregullore e programit të studimit Bachelor në FE.</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.14.5.Udhezues diplome</i></p> <p><i>Evidenca nr.24. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në Finance</i></p> <p><i>Vizita në institucion e GVJ dhe takim me stafin, studentet dhe sekretarinë mësimore.</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>DF dhe DK, si njësi bazë të programit, së bashku me strukturat ndihmëse, informojnë, ndjekin dhe monitorojnë procesin përgatitjes dhe mbrojtjes së diplomës me punim e diplome. Për studentët që do përmbyllin studimet me punim diplome ,pas marrjes së informacionit ata plotësojnë formularin e aplikimit ku përcaktojnë fushën e studimit, strukturën paraprake të tij dhe propozimin për udhëheqësin e punimit sipas udhëzuesit të përmendur më lart. Në DF dhe DK përcaktohen udhëheqësit për çdo student, të cilët kanë përgjegjësi për mbarëvajtjen e këtij procesi, cilësinë dhe përfundimin në afat. Ky proces u evidentua edhe gjatë vizitës në institucion. Në ndihmë të studentëve për këtë qëllim organizohet seanca metodologjike në auditor ku jepen udhëzimet përkatëse për përgatitjen e punimit përmbyllës.</p> <p><i>Evidenca nr.1.2. Rregullore e UT</i></p> <p><i>Evidenca nr.2.36. Rregullore e programit të studimit Bachelor në FE.</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.14.5.Udhezues diplome</i></p> <p><i>Evidenca nr.24. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në Finance</i></p> <p><i>Vizita në institucion e GVJ dhe takim me stafin, studentet dhe sekretarinë mësimore.</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Lidhur me diplomimin e studentëve, me propozim të përgjegjësit të Departamentit dhe miratimit nga Dekani, ngrihet Komisioni i Provimit të Formimit 5 anëtarë i cili në vlerësimin e punimit të diplomës bazohet në disa kriterë kryesore si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ecurinë dhe nivelin e vlerësimit të marrë në mësimet gjatë vitit akademik; • Përdorimi i metodologjisë të punimit; • Originaliteti i punimit; • Dobia e punimit; • Cilësia e të shkruajturit;

	<ul style="list-style-type: none"> • Paraqitja teknike; • Cilësia e prezantimit; • Vlerësimin që jep pedagogu udhëheqës i punimit të studentit në formularin përkatës; <p>GVJ konstatoi se kjo praktikë rezulton e plotësuar nga evidentimi me studentë e programeve të tjera që kanë përfunduar programin, pasi studentët e këtij programi ende nuk e kanë përmbyllur programin. Struktura e temës së diplomës është e përcaktuar në udhëzuesin e diplomës.</p> <p><i>Evidenca nr.1.2. Rregullore e UT</i></p> <p><i>Evidenca nr.2.36. Rregullore e programit të studimit Bachelor në FE.</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.14.5.Udhezues diplome</i></p> <p><i>Evidenca nr.24. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në Finance</i></p> <p><i>Vizita në institucion e GVJ dhe takim me stafin, studentet dhe sekretarinë mësimore.</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Në funksion të fushës së punimit të propozuar nga studenti, DF dhe DK miratojnë listën e pedagogëve udhëheqës për temat e studentëve. Udhëheqësit e punimeve të diplomave gjatë periudhës së përgatitjes së tij nga studenti mbajnë komunikim të vazhdueshëm duke i orientuar përgjatë kësaj kohe. Roli udhëheqës i pedagogut është këshillues dhe orientues lidhur me përmbushjen e objektivave të qëllimit të punimit, shfrytëzimin e literaturës bashkëkohore nga studenti dhe përfshirja e analizës teorike praktike në punim. Bazuar në numrin e lart të studentëve që ndjekin studimet në këtë program dhe që diplomohen çdo vit (rreth 400 studente) edhe numri i studenteve për një pedagog është relativisht i lartë.</p> <p>Nga takimi me studentët e këtij programi, u evidentua bashkëpunimi deri në këtë fazë afër përmbylljes të realizimit të punimit të diplomës me udhëheqësin e punimit. Kjo manifestohet në ndjekjen sistematike dhe këshillat e vazhdueshme për studentët, duke filluar që nga faza e konceptimit. Rol të rëndësishëm ai ka në asistencën që jep sidomos me metodologjinë e punimit që është kyçi i një punimi të suksesshëm dhe sidomos në aspektin e aplikimit të të dhënave të siguruara. Në rastin e punimeve të diplomës për studentët e këtij programi synohet që ai në strukturë trajtimi aplikativ të zërë një peshë të konsiderueshme.</p>

	<p><i>Evidence nr.14.6.Lista e drejtuesve te diplomës +praktika</i></p> <p><i>Evidence1.12.Rregullore UT</i></p> <p><i>Evidenca nr.2.36. Rregullore e programit të studimit Bachelor në FE.</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.14.5.Udhezues diplome</i></p> <p><i>Evidenca nr.24. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në Finance</i></p> <p><i>Vizita në institucion e GVJ dhe takim me stafin dhe studentet</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Gjatë përpunimit të të dhënave të punimit, studentët kanë të gjitha mundësitë teknike dhe asistencën e nevojshme për të realizuar këtë fazë të rëndësishme të punimit në laboratorët që ofron njësia kryesore FE dhe ajo baze DF dhe DK, bibliotekën dhe çdo infrastrukturë të dobishme për ta.</p> <p><i>Takim me stafin dhe studentet në institucion</i></p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Komisioni i Provimit të Formimit bazuar në komponentët e vlerësimit të përcaktuara në formularin përkatës dhe të plotësuar nga pedagogu udhëheqës i punimit si dhe vlerësimin nga prezantimi i punimit para tyre bën vlerësimin e punimit të diplomës me notë përfundimtare dhe i bëhet të ditur studentit në fund të seancës së mbrojtjes. Nota përfundimtare del si mesatare e të gjitha vlerësimeve të secilit anëtar të Komisionit të posaçëm.</p> <p><i>Evidenca nr.2.36. Rregullore e programit të studimit Bachelor në FE.</i></p> <p><i>Evidenca nr.3.14.5.Udhezues diplome</i></p> <p><i>Evidenca nr.24. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në Finance</i></p> <p><i>Vizita në institucion e GVJ takim me stafin, studentet dhe monitorimi i ambienteve të institucionit.</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje</p>	<p>Në përfundim të studimeve studenti pajiset me diplomën “Bachelor ne Finance” dhe suplementin e saj të miratuar nga MASR. Diplomës i bashkëngjitet edhe lista e notave. GVJ verifikoi praktikën përkatëse lidhur me diplomimin e studentëve në këtë program që i përket vitit akademik 2023-2024. Në rast se studenti kërkon dhe kopje të programit të studimit me përmbajtjen lëndore me kërkesën e tij ai pajiset me këtë dokumentacion brenda afatit të caktuar në rregullore kundrejt pagesës se tarifës.</p>

e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	<p><i>Evidenca nr.3.18. Diploma dhe suplement diplome</i></p> <p><i>Evidenca nr.2.36. Rregullore e programit të studimit Bachelor në FE.</i></p> <p><i>Evidenca nr.83.Modeli suplement i diplomës Bachelor në Financë Takim në sekretarinë e institucionit</i></p>			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	<p>Nga vizita në FE te UT rezulton se procesi i ruajtjes së gjithë dokumentacionit bazohet në kërkesat ligjore dhe aktet nënligjore në fuqi. Gjithashtu të dhënat e tij ruhen krahas regjistrave përkatës me informacionin e matricullimit edhe në sistemin informativ të institucionit. Sekretaria mësimore disponon çdo informacion zyrtare lidhur me kërkesa të mundshme të studenteve të diplomuar me pare.</p> <p><i>Evidenca 1.12.Rregullore UT</i></p> <p><i>Evidenca nr.2.11.Manuali i Arkives</i></p> <p><i>Takim në sekretarinë e institucionit</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ vlerëson se institucioni ka një procedure të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentëve dhe i pajis ata me dokumentacionin e nevojshëm në përfundim të programit. Procesi i përmbylljes së detyrimeve të studenteve bazohet në rregulloren e përgjithshme të UT dhe rregulloren e vetë programit të studimit.</i></p> <p><i>Në mënyrë më të detajuar institucioni ka hartuar edhe udhëzuesin përkatës të përgatitjes dhe mbrojtjes së diplomës. GVJ evidentoi këtë proces edhe nga takimi me stafin akademik të programit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardevë të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1




Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiorë dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret **Vlerësimi i ekspertëve**

Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

Departamenti i Financës dhe Departamenti i Kontabilitetit janë njësitë bazë përgjegjëse për zhvillimin dhe realizimin e këtij programi studimi. Staf i akademik i angazhuar për mësimdhënie përbëhet kryesisht nga stafet e këtyre dy departamenteve. Në varësi të përmbajtjes dhe specifikave të lëndëve, përfshihen edhe staf PAK.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi se, prej vitit akademik 2022 deri në vitin akademik 2025, programi i ciklit të parë Bachelor në “Financë” është mbuluar në mënyrë të qëndrueshme nga një strukturë akademike e organizuar, siç pasqyrohet edhe në evidencat në tabelat përmbledhëse, që përfshijn të dhëna mbi PAE dhe PAK. Të dhënat mbi stafin e përfshirë në mësimdhënie për këtë program gjatë tre viteve të akademike për të dy departamentet përgjegjës janë:

Tituj/grada	2022 - 2023		2023 - 2024		2024 - 2025	
	PAE	PAK	PAE:	PAK:	PAE:	PAK:
Prof.Dr	14	-	14	-	15	-
Prof.As.Dr	19	-	24	2	24	-
Dr/PhD	35	13	33	12	26	9
Dr/Phd në proces	36	14	42	18	41	25
Msc	14	51	-	39	-	33
Në total	104	78	113	71	106	67

Në vitin akademik 2024–2025, bazuar në evidencat e dokumentuara dhe konfirmimet e bëra gjatë vizitës në institucion, në program janë të angazhuar gjithsej 106 pedagogë PAE. 15 prej tyre mbajnë titullin “Profesor Doktor”, 24 kanë gradën “Profesor i Asociuar”, 26 zotërojnë gradën shkencore “Doktor”, dhe 41 janë në proces të ndjekjes së studimeve doktorale.

Numri i pedagogëve PAK vitin akademik 2024–2025 është 67. Ku 9 mbajnë gradën “Doktor”, 25 janë në proces doktorature dhe 33 kanë përfunduar ciklin e studimeve “Master Shkencor”.

Bazuar në analizën e CV-ve të stafit të përfshirë në program, vërehet se përbërja dhe kualifikimet e stafit akademik

	<p>përbushin kërkesat ligjore dhe standardet e nevojshme për mbështetjen e programit të studimit në fushën përkatëse.</p> <p><i>Evidenca 0.3_Tabelat përmbledhëse 6.1; 6.2; 6.3, për Aneks_RVB.</i> <i>Evidenca 3.12_CV_PAE_PAK_Joakademik</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>								
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Nga verifikimi i të dhënave statistikore të pasqyruara në tabelat përmbledhëse të RVB-së, rezulton se në vitin akademik 2024–2025, pedagogët me angazhim të plotë PAE mbulojnë 76% të ngarkesës mësimore totale në auditor për këtë program studimi. Ky raport është në përputhje me kërkesat e kornizës ligjore në fuqi për përfshirjen e stafit me kohë të plotë në mësimdhënie.</p> <table border="1" data-bbox="611 837 1321 1016"> <thead> <tr> <th><i>Raporti</i></th> <th><i>2022-2023</i></th> <th><i>2023-2024</i></th> <th><i>2024-2025</i></th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Ngarkesa e PAE/Totali i Orëve në Auditor</td> <td>75%</td> <td>80%</td> <td>76%</td> </tr> </tbody> </table> <p><i>Evidenca 0.3_Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB.</i> <i>Evidenca 3.12_CV_PAE_PAK_Joakademik</i></p>	<i>Raporti</i>	<i>2022-2023</i>	<i>2023-2024</i>	<i>2024-2025</i>	Ngarkesa e PAE/Totali i Orëve në Auditor	75%	80%	76%
<i>Raporti</i>	<i>2022-2023</i>	<i>2023-2024</i>	<i>2024-2025</i>						
Ngarkesa e PAE/Totali i Orëve në Auditor	75%	80%	76%						
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Bazuar në të dhënat e RVB-së së institucionit dhe dokumentacionin shoqëruar të aplikimit për akreditim, konstatohet një qëndrueshmëri e vazhdueshme e personelit akademik të angazhuar në këtë program gjatë viteve të fundit. Verifikimet e kryera nga GVJ pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore (ZBNJ) konfirmojnë se PAE dhe PAK janë të punësuar me kontrata pune që parashikojnë qartë detyrimet e ndërsjella, përfshirë kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti_UT</i> <i>Evidenca 1.6_Manual mbi Punësimin e Personelit ne UT</i> <i>Evidenca 2.37_Procedurë rekrutimi tip</i> <i>Evidenca 1.32_Model kontrate person.akad.me kohe të plote</i> <i>Evidenca 1.33_Model kontrate personel akademik me kohe të pjesshme</i></p>								
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur</p>	<p>Kriteret specifike përcaktohen nga Departamenti përkatës, bazuar në nevojat për zgjerimin e kapaciteteve akademike. Ato përfshijnë, ndër të tjera, njohjen dhe zhvillimin e lëndëve për</p>								

<p>në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>të cilat bëhet rekrutimi, në përputhje me programin ku ato zhvillohen, si dhe preferencat për kualifikime jashtë vendit në fushën përkatëse. Kriteret e rekrutimit i përcillen Rektorit nga drejtuesi i njësisë përkatëse. Procesi i përzgjedhjes zhvillohet në dy faza:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Verifikimi i dokumentacionit të aplikantëve; 2. Intervistimi i kandidatëve që kualifikohen pas shqyrtimit të dosjeve; <p>Komisioni përkatës harton vendimin përfundimtar duke renditur kandidatët sipas pikëve të grumbulluara. Lista e përzgjedhur i dorëzohet titullarit të njësisë kryesore FEUT, i cili e përcjell te Rektori i UT për miratimin përfundimtar të fituesit.</p> <p><i>Evidenca 1.1_Statuti_UT</i> <i>Evidenca 1.2_Rregullore_UT</i> <i>Evidenca 2.37_Procedurë rekrutimi tip</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Financës dhe Departamenti i Kontabilitetit, përgjegjës për këtë programi studimi, kanë në përbërje edhe personel ndihmës akademik të angazhuar për garantimin e mbarëvajtjes së procesit mësimor. Ky personel është aktiv në laboratorë dhe në mjedise të tjera në dispozicion të studentëve, duke kontribuar në mënyrë funksionale dhe të koordinuar në zhvillimin efektiv të veprimtarisë mësimore, në varësi të nevojave të programit. Përfshirja dhe funksionimi i këtij personeli u konfirmua edhe nga GVJ gjatë vizitës në institucion.</p> <p><i>Evidenca 1.1_Statuti_UT</i> <i>Evidenca 0.3_Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB.</i> <i>Evidenca 0.4_Dosja e Programit të Studimit</i> <i>Vizita e GVJ në institucion</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të</p>	<p>Në bazë të rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e administratës së Rektoratit të UT-së”, miratuar më 27.01.2022, neni 10 parashikon krijimin e Drejtorisë së Shërbimit të Brendshëm (ish-Drejtoria e Burimeve Njerëzore), e cila në nivel institucional mbulon edhe procedurat e punësimit të personelit akademik dhe joakademik. Këto funksione realizohen nga sektori i Burimeve Njerëzore, si një nga strukturat e kësaj Drejtorie, i cili gjithashtu është</p>




<p>dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>përgjegjës për ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p> <p>Në nivelin e njësisë kryesore FEUT (Fakulteti i Ekonomisë i UT), funksionon Dega e Burimeve Njerëzore dhe Protokoll Arkivës, e cila mbulon procesin e rekrutimit të stafit akademik dhe monitoron dokumentacionin përkatës, përmes pasurimit të dosjeve në mënyrë të vazhdueshme dhe në kohë. Nga takimi me drejtuesen e kësaj Dege, si edhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, u konstatua se ajo është përgjegjëse për administrimin e plotë të të gjitha procedurave që lidhen me stafin e angazhuar në fakultet, përfshirë ruajtjen dhe përditësimin vjetor të të dhënave të personelit efektiv dhe atij të angazhuar me kontratë.</p> <p>Procesi i rekrutimit zhvillohet në përputhje me kriteret e përcaktuara nga Departamenti përkatës. Pas shpalljes së pozicionit, aplikimet shqyrtohen nga personeli përgjegjës dhe kandidatët që përmbushin kriteret kalojnë në fazën e intervistës. Dega e Burimeve Njerëzore është e përfshirë në të gjitha etapat e këtij procesi, duke garantuar transparencën dhe respektimin e kërkesave ligjore dhe institucionale. Nga shqyrtimi i dy dosjeve të përzgjedhura në mënyrë rastësore PAE dhe PAK nuk u evidentuan mangësi në dokumentacion. Dosjet e stafit të përfshirë në programin e studimit përmbajnë dokumentacionin përkatës si: kontrata e punës, diplomat dhe listat e notave të noterizuara për studimet universitare, master dhe doktoraturë, CV, si dhe të dhëna të tjera mbi kualifikimet, pjesëmarrjen në veprimtari akademike dhe kërkimore, brenda dhe jashtë vendit.</p> <p><i>Evidenca 1.4 Rregullore e brendshme e punës së UT "Për organizimin dhe funksionimin e administratës së rektoratit të UT"</i></p> <p><i>Evidenca 1.9 Rregullore "Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në Universitetin e Tiranës".</i></p> <p><i>Evidenca 2.33 Organigrama FEUT_2025</i></p> <p><i>Evidenca 0.3 Tabelat përmbledhëse</i></p> <p><i>Shqyrtimi i dosjeve të personelit gjatë vizitës në institucion</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në</p>	<p>Fakulteti i Ekonomisë i UT (FEUT) ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me kompani dhe përfaqësues të biznesit, të cilat shërbejnë si mbështetje për organizimin e leksioneve të hapura dhe për realizimin e praktikës profesionale të studentëve.</p>

<p>dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Stafi akademik i programit është aktivisht i angazhuar në monitorimin e zhvillimit të praktikës profesionale pranë këtyre institucioneve partnere. Praktika profesionale, si një komponent thelbësor i programit të studimeve në fushën e financës, zbatohet në mënyrë të strukturuar. Gjatë vizitës në institucion, GVJ evidentoi se anëtarë të stafit caktohen për të ndjekur ecurinë e praktikës së studentëve, si dhe për të udhëhequr procesin e përgatitjes së diplomës.</p> <p><i>Evidenca 2.21_Marrëveshje Ndërinstitucionale</i></p> <p><i>Evidenca 2.21.1_Kopje marrëveshje ndërinstitucionale</i></p> <p><i>Evidenca 2.22_Linqe për Workshop-e, Leksione të hapur dhe Aktivitete të tjera</i></p> <p><i>Evidenca 3.13_Formular Vlerësimi - Temë Diplome për Ciklin e Parë Bachelor</i></p> <p><i>Evidenca</i></p> <p><i>3.14.1_Formular Miratimi Praktika Mësimore Bachelor</i></p> <p><i>Evidenca</i></p> <p><i>3.14.2_Formular Vlerësimi Studenti Praktika Mësimore Bachelor</i></p> <p><i>or</i></p> <p><i>Evidenca</i></p> <p><i>3.14.3_Formular Vlerësimi Studenti Praktikant Pedagogu Udhëheqës Bachelor</i></p> <p><i>Evidenca</i></p> <p><i>3.14.4_Formular Raporti Përfundimtar Praktika Mësimore Bachelor</i></p>
<p>Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritisë që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Gjatë takimeve me stafin akademik të programit të ciklit të parë Bachelor në “Financë”, si dhe me studentët, u evidentua roli aktiv i pedagogëve në monitorimin e praktikës profesionale. Po ashtu, u vlerësua mbështetja që ata ofrojnë në hartimin e raportit përfundimtar që studenti dorëzon pas mbylljes së praktikës.</p> <p><i>Evidenca 3.13_Formular Vlerësimi - Temë Diplome për Ciklin e Parë Bachelor</i></p> <p><i>Evidenca3.14.1_Formular Miratimi Praktika Mësimore Bachelor</i></p> <p><i>Evidenca3.14.2_Formular Vlerësimi Studenti Praktika Mësimore Bachelor</i></p> <p><i>Evidenca3.14.3_Formular Vlerësimi Studenti Praktikant Pedagogu Udhëheqës Bachelor</i></p> <p><i>Evidenca 3.14.6_Lista e drejtuesve diploma + praktika Bachelor 24-25</i></p> <p><i>Vizita në institucion nga GVJ</i></p>

Konkluzione	<i>Bazuar në dokumentacionin e ofruar dhe vizitën e realizuar, GVJ konstaton se stafi akademik i angazhuar në këtë program ka qenë i qëndrueshëm. Ai ndjek aktivisht procesin mësimor dhe praktikën profesionale të studentëve, duke ofruar mbështetje edhe për hartimin e raporteve përfundimtare dhe udhëheqjen e temave të diplomës, ndërsa marrëveshjet me institucione partnere kanë mundësuar realizimin efektiv të praktikës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	<p>Duke iu referuar dokumentacionit të përcjellë dhe vizitës në institucion, në kuadër të vlerësimit të infrastrukturës së Fakultetit të Ekonomisë të UT, veçanërisht në njësitë bazë si Departamenti i Financës dhe Departamenti i Kontabilitetit, GVJ konstaton se institucioni disponon ambiente të përshtatshme për zhvillimin me sukses të programit. Procesi mësimor zhvillohet në godinat <i>A (tre kate)</i> dhe <i>B (gjashtë kate)</i>, të pajisura me salla leksionesh dhe auditorë për seminare.</p> <p>Gjithashtu, ekzistojnë hapësira të dedikuara për stafin akademik dhe ndihmës, që përmbushin kërkesat funksionale dhe mbështetëse të programit. Zyrat që mbulojnë funksione mbështetëse përfshirë Burimet Njerëzore, Financën, Bibliotekën, Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Sekretarinë, janë të akomoduar në ambiente përkatëse dhe të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për funksionim normal dhe efikas të veprimtarive të tyre.</p> <p><i>Evidenca 0.3 Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB.</i> <i>Evidenca 0.4 Dosja e Programit të Studimit</i> <i>Vizita e GVJ në institucion</i></p>

<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, u konstatua se infrastruktura e vënë në dispozicion për programin e studimeve Bachelor në “Financë” është e mjaftueshme dhe në përputhje me kërkesat funksionale dhe ligjore për zhvillimin e procesit mësimor.</p> <p>Ambjentet përfshijnë salla leksionesh, zyra për stafin akademik dhe administrativ, si dhe laboratorë të dedikuar. FEUT, bashkë me Departamentin e Financës dhe Departamentin e Kontabilitetit, zotërojnë hapësira të përshtatshme për garantimin e një zhvillimi cilësor dhe të suksesshëm të programit Bachelor në “Financë”.</p> <p>Infrastruktura respekton plotësisht kriteret teknike dhe standardet e sipërfaqes së shfrytëzueshme të përcaktuara në VKM nr. 418, datë 10.05.2017, “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe degëve të tyre”, ku parashikohet një minimum prej 2.5 m² për student. Mjediset ku zhvillohet procesi mësimor janë të pajisura me të gjitha mjetet didaktike dhe pajisjet teknike të nevojshme, duke mundësuar përmbushjen e kërkesave të moduleve dhe realizimin e objektivave formuese të programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca 2.22.1 Infrastruktura e kërkimit shkencor 2023-2024</i> <i>Konstatimet e GVJ gjatë vizitës në Fakultetin e Ekonomisë të UT</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Për mbështetjen e procesit mësimor dhe aktiviteteve kërkimore-shkencore, institucioni vë në dispozicion 10 laboratorë, të pajisur me programe bashkëkohore dhe të aksesueshëm nga studentët dhe stafi akademik. Këto laboratorë shfrytëzohen për zhvillimin e seminareve, realizimin e detyrave të kursit dhe përgatitjen e temave të diplomës.</p> <p><i>Evidenca 4.1 Foto dhe video të laboratorëve dhe ambienteve</i> <i>Vizita e GVJ në institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale</p>	<p>Programet e instaluar në kompjuterët e laboratorëve janë moderne dhe përfshijnë, përveç aplikacioneve bazë, edhe softuerë të specializuar të lidhur me lëndët përbërëse të programit, si Ekonometria, e cila përdor modele statistikore dhe ekonometrike për analizë dhe interpretim të të dhënave. Gjithashtu, programi zhvillohet edhe në tre salla laboratorike,</p>

sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	ku janë instaluar programet Balance dhe Alpha, të cilat mbështesin procesin mësimor dhe zhvillimin praktik të studentëve në fushën e financës dhe kontabilitetit			
	<i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion</i>			
Konkluzione	<i>GVJ, bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni dhe konstatimet gjatë vizitës në terren, vlerëson se mjediset mësimore dhe infrastruktura mbështetëse janë të përshtatshme dhe përmbushin kushtet për zhvillimin normal dhe cilësor të programit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Duke u mbështetur në dokumentacionin e aplikimit të dorëzuar nga institucioni dhe në konstatimet e GVJ gjatë vizitës në ambientet e bibliotekës së Universitetit të Tiranës, rezulton se për modulet dhe lëndët e programit studentëve u ofrohet literaturë bazë dhe ndihmëse, e përcaktuar në syllabus-et përkatëse, si në format fizik ashtu edhe në versionin digjital. Biblioteka përmban tituj në gjuhën shqipe dhe të huaj, përfshirë literaturë të viteve të fundit që mbështet formimin akademik të studentëve. GVJ e vlerëson këtë fond me botime të reja, në gjuhë të huaj dhe të specializuara për fushat e programit të studimit. <i>Evidenca 2.2.2 Relacioni i bibliotekës viti 2022</i> <i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Duke u mbështetur në dokumentacionin e aplikimit të dorëzuar nga institucioni dhe në vizitën e GVJ pranë bibliotekës, konstatohet se njësitë përgjegjëse përditësojnë literaturën me botime të viteve të fundit. Sipas evidencave dhe gjatë vizitës në Fakultetin e Ekonomisë të UT, u vërejt se stafi akademik propozon vazhdimisht shtimin e literaturës me tekste bashkëkohore, të cilat përdoren në kuadër të këtij programi.

	<p>Gjithashtu, FEUT buxheton çdo vit një fond të veçantë, i cili i dedikohet shtimit të fondeve të librave, duke siguruar pasurimin dhe përditësimin e literaturës për studentët dhe stafin akademik.</p> <p><i>Evidenca 2.2 _Informacion për Bibliotekën</i> <i>Evidenca 2.4.1 _Lista e librave 2023-2024</i> <i>Evidenca 3.17 _Kërkesë pedagogu për blerje libri</i> <i>Evidenca 2.31 _Buxheti i miratuar 2025</i> <i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit dhe vizitës në FEUT, u vërejt se studentët e programit të Bachelor në “Financë” kanë akses të drejtpërdrejtë në Bibliotekën Mësimore. Studentët kanë mundësi të barabarta për të shfrytëzuar shërbimet e bibliotekës, për të studiuar dhe për të aksesuar literaturën e ofruar. Orari dhe organizimi i shërbimeve janë të përshtatura për të përmbushur nevojat e studentëve, duke qenë se biblioteka qëndron e hapur nga e hëna deri të premten, në oraret 08:30–19:30. Gjatë sezonit të provimeve, për të mbështetur studentët, biblioteka ofron shërbime edhe të shtunave dhe të dielave, në të njëjtin orar, 08:30–19:30.</p> <p><i>Evidenca 2.1 _Rregullore e bibliotekës së FEUT</i> <i>Evidenca 2.2.3 _Foto të bibliotekës</i> <i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita në institucion rezulton se Biblioteka është e pajisur me një fond fizik, me rreth 5,703 tituj në shqip dhe anglisht, që përfshijnë tekste mësimore, libra, revista periodike, buletine të institucioneve, si dhe punime mikroteze dhe doktorature. Shërbimi i bibliotekës sigurohet nga tre punonjës dhe ofrohet në dy ambiente të veçuara: në vendin e tërheqjes së librave dhe në sallën e hapur për studim.</p> <p><i>Evidenca 2.2 _Informacion për Bibliotekën</i> <i>Evidenca 2.2.1 _J.Limprecht Historiku Biblioteka</i> <i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion</i></p>

<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Shërbimet aktuale të bibliotekës ofrojnë akses të barabartë për të gjithë përdoruesit potencialë, përfshirë studentët dhe stafin akademik, pa asnjë kosto, pasi ata regjistrohen si anëtarë. Gjithashtu, biblioteka ofron shërbime online përmes marrëveshjes së bashkëpunimit të UT me Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF), që siguron abonim në bibliotekën digjitale JSTOR, me akses në rreth 85,000 tituj. Biblioteka e Fakultetit të Ekonomisë është gjithashtu pjesë e programit COBIS, që i mundëson përdoruesve të saj akses në baza të dhënash dhe informacion të specializuar në fushën e ekonomisë, të dobishëm për analiza dhe punime kërkimore shkencore.</p> <p><i>Evidenca 2.3_Marrëveshjet për bibliotekat online</i> <i>Evidenca 2.3.1_Manual J-store.</i> <i>Evidenca 2.3.2_Manual Ulibrary</i> <i>Evidenca 1.36_Marrëveshje Bashkëpunimi mes AADF dhe UT</i></p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Biblioteka përdor një program kompjuterik për kërkimin dhe gjetjen e titujve të librave, duke e bërë procesin të shpejtë dhe efikas. Përveç kësaj, kompjuterët në ambientet e bibliotekës janë në dispozicion të studentëve pa kufizime. Studentët kanë akses të plotë për të siguruar botime online, përfshirë përdorimin e disa adresave të specializuara që janë funksionale për bibliotekën elektronike.</p> <p><i>Evidenca 2.2 Informacion për Bibliotekën</i> <i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion</i></p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka ofron shërbime për studentët e këtij programi nga ora 08:30 deri në 19:30, përfshirë ata që zhvillojnë mësimin në pasdite. Gjatë sezonit të provimeve, biblioteka qëndron e hapur edhe të shtunave dhe të dielave, në të njëjtin orar, duke siguruar mbështetje të plotë për nevojat e studentëve edhe gjatë sezonit të provimeve.</p> <p><i>Evidenca 2.1_Rregullore e bibliotekës së FEUT</i> <i>Evidenca 2.2 Informacion për Bibliotekën</i></p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e</p>	<p>GVJ, bazuar në dokumentacionin e aplikimit për akreditim dhe vizitën në Fakultetin e Ekonomisë të UT, vëren se ekziston një komunikim institucional i mirëorganizuar për pasurimin e fondit të bibliotekës me tituj të rinj. Çdo vit akademik,</p>

<p>fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>biblioteka pasurohet në përputhje me kërkesat e stafit akademik dhe programet mësimore, duke siguruar mbështetje të vazhdueshme për studentët.</p> <p><i>Evidenca 2.2.2_Relacioni i bibliotekës viti 2022</i> <i>Evidenca 2.2_Informacion për Bibliotekën</i> <i>Evidenca 2.4.1_Lista e librave 2023-2024</i> <i>Evidenca 3.17_Kërkesë pedagogu për blerje libri</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në dokumentacionin dhe vëzhgimet gjatë vizitës në FEUT, GVJ konstaton se biblioteka ofron shërbime të organizuara dhe të aksesueshme për studentët dhe stafin akademik.</i></p> <p><i>Fondi i saj pasurohet çdo vit me tituj të rinj në përputhje me programet mësimore dhe kërkesat e stafit, duke siguruar mbështetje të vazhdueshme për zhvillimin e procesit mësimor dhe kërkimit shkencor.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi IV.4</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>




<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Për menaxhimin e të dhënave të studentëve, i UT përdor platformën “e-student”, e cila mbështet të gjithë ciklin e menaxhimit të informacionit, nga regjistrimi deri në diplomim. Gjatë vizitës, GVJ zhvilloi takime dhe monitorime pranë sekretarisë mësimore të FEUT, ku evidentoi administrimin e të dhënave të studentëve në të gjitha fazat e procesit.</p> <p>GVJ konstatoi ekzistencën e regjistrave themeltarë për studentët e këtij programi dhe verifikoi dy raste specifike, duke kontrolluar dosjet e studentëve në fillim të procesit mësimor, regjistrat e grupeve, procesverbalet e vlerësimit dhe regjistrimin e tyre në regjistrin themeltar.</p> <p><i>Evidenca 1.28_Manual-Sistemi e-student.</i></p> <p><i>Evidenca 1.29_Rregullore-për-funksionimin-e-sistemit-informatik</i></p> <p><i>Evidenca 1.9_Rregullore “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në Universitetin e Tiranës”.</i></p> <p><i>Evidenca 2.18_Rregullore e Sekretarisë Mësimore, FEUT</i></p> <p><i>Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Për menaxhimin e të dhënave të studentëve, Fakulteti i Ekonomisë i UT përdor platformën “E-Student”, e cila mbulon të gjithë ciklin e menaxhimit të informacionit, nga regjistrimi deri në diplomim. Gjatë vizitës, GVJ evidentoi administrimin e të dhënave nga sekretaria mësimore, duke përfshirë regjistrat themeltarë, dosjet e studentëve, regjistrat e grupeve dhe procesverbalet e vlerësimit. Staf i akademik dhe studentët, pas kërkesës së tyre, kanë akses në informacionin që menaxhohet nga sekretaria. Për këtë qëllim, është ngritur dhe funksionon “Sistemi i Menaxhimit të Informacionit (SIM)”, i cili mundëson përdoruesve të autorizuar, pedagogë, studentë dhe staf IT ,të kenë akses të sigurt dhe të strukturuar në të dhënat akademike.</p> <p><i>Evidenca 2.5_Përdorues të SIM – print screen</i></p> <p><i>GVJ nga vizita në FEUT</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Personeli akademik dhe studentët kanë akses të kontrolluar në informacionin e administruar nga Sekretaria Mësimore dhe Zyra e Burimeve Njerëzore, nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit të Informacionit (SIM). Ky sistem elektronik u mundëson përdoruesve të autorizuar përfshirë pedagogët, studentët, Degën e IT-së, sekretaritë e departamenteve, dekanët dhe zëvendësdekanët qasje të strukturuar dhe të përditësuar mbi të</p>

	<p>gjitha komponentët e ciklit akademik, dosjet e stafit akademik, etj.</p> <p><i>Evidenca 2.5_Përdorues të SIM – print screen</i> <i>Evidenca 1.2_Rregullore UT</i> <i>GVJ nga vizita në FEUT</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Institucioni, konkretisht Fakulteti i Ekonomisë i Universitetit të Tiranës (FEUT), siguron shpërndarjen e informacionit edhe nëpërmjet platformave dhe moduleve që mbështesin komunikimin interaktiv ndërmjet stafit akademik dhe studentëve. Në mënyrë të veçantë, FEUT përdor platformën Microsoft Teams për ndërveprim të vazhdueshëm në procesin mësimor dhe administrativ. Informacioni plotësues dhe njoftimet zyrtare shpërndahen gjithashtu përmes faqes zyrtare të fakultetit, rrjeteve sociale dhe kanaleve të tjera të institucionit, duke garantuar transparencë dhe akses të gjerë në të dhëna.</p> <p><i>Evidenca 2.28_Screenshot te datave te provimeve, etj, nga faqja FEUT</i> <i>Evidenca 3.8_Screenshot i komunikimeve zyrtare në Teams</i> <i>Evidenca 1.28_Manual-Sistemi e-student</i></p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Universiteti i Tiranës siguron informacionin e nevojshëm përmes platformës e-student, e cila është e integruar me SIM dhe mundëson komunikim interaktiv si dhe shkëmbim të strukturuar të informacionit ndërmjet personelit akademik, ndihmësakademik dhe studentëve. Sistemi lejon gjenerimin e raporteve individuale, si për studentët ashtu edhe për stafin akademik drejtues, duke mbështetur monitorimin e regjistrimeve, notave, progresit akademik dhe ngarkesës mësimore. Komunikimi zyrtar dhe vijueshmëria e ndërveprimit mbështeten gjithashtu përmes platformës Microsoft Teams dhe e-mailit institucional.</p> <p><i>Evidenca 1.28_Manual-Sistemi e-student.</i> <i>Evidenca 1.29_Rregullore-për-funksionimin-e-sistemit-informatik</i> <i>Evidenca 1.18_Manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik i UT</i> <i>Evidenca 2.28_Screenshot te datave te provimeve, etj, nga faqja FEUT</i> <i>Evidenca 3.8_Screenshot i komunikimeve zyrtare në Teams</i></p>

		<i>GVJ nga vizita në FEUT</i>			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	<p>Nga konstatimi i Grupit të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), faqja zyrtare FE të UT përmbajnë informacion të detajuar në lidhje me programet e studimit, stafin akademik, oraret, datat e provimeve, si dhe mundësi punësimi për studentët. Përveç publikimeve në gjuhën shqipe, një pjesë e konsiderueshme e njoftimeve dhe informacionit publikohet edhe në gjuhë të huaj, kryesisht në anglisht. Gjithashtu, FEUT është aktiv në rrjetet sociale, ku shpërndajnë në mënyrë të vazhdueshme informacione lidhur me programet, aktivitetet akademike dhe ndërkombëtare, duke rritur vizibilitetin dhe aksesin për një audiencë më të gjerë.</p> <p>https://feut.edu.al/ https://feut.edu.al/lajmerime/2817-njoftim-per-studentet-e-vitit-tre-te-programit-bachelor-ne-finance https://feut.edu.al/lajmerime/2809-weboju</p>				
Konkluzione	<p><i>Bazuar në dokumentacionin e ofruar dhe vizitën në FEUT, GVJ konkludon se sistemi i brendshëm i menaxhimit të informacionit për administrimin dhe monitorimin e veprimtarisë akademike përmbush nevojat e procesit mësimor, stafit akademik dhe studentëve.</i></p> <p><i>FEUT shpërndan informacionin akademik dhe administrativ përmes, e-student, Microsoft Teams, faqes zyrtare dhe rrjeteve sociale, duke përfshirë programet, regjistrimet, notat, progresin akademik dhe ngarkesën mësimore, duke garantuar transparencë dhe akses të gjerë.</i></p>				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
				X	

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), referuar dokumentacionit të dorëzuar, konstaton se FEUT për këtë program studimi ka hartuar një plan financiar të detajuar, duke llogaritur koston për student bazuar në elementët përbërës të shpenzimeve dhe të

<p>e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>ardhurave të pritshme. Kjo pasqyrohet qartë edhe në projektbuxhetet dhe buxhetet e miratuara për çdo vit, të cilat garantojnë mbarevajtjen e programit gjatë gjithë ciklit të studimeve.</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti UT</i></p> <p><i>Evidenca 2.30.1 Projekt buxheti 2024</i></p> <p><i>Evidenca 2.31.1 Buxheti i miratuar 2024</i></p> <p><i>Evidenca 2.31 Buxheti i miratuar 2025</i></p> <p><i>Evidenca 2.35 Raporti vjetor FEUT 2023-2024</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Plani financiar i njësisë përgjegjëse për programin e studimit në FEUT përfshin llogaritjen e kostos për student, parashikimin e të ardhurave nga tarifat dhe burime të tjera financiare, si dhe hartimin e buxheteve vjetore të miratuara që sigurojnë financimin e aktiviteteve akademike gjatë gjithë ciklit të studimeve. Ky plan garanton administrimin dhe monitorimin e shpenzimeve në përputhje me objektivat e programit, duke siguruar mbarëvajtjen dhe qëndrueshmërinë e tij.</p> <p><i>Evidenca 2.30.1-3 Projekt buxheti 2024</i></p> <p><i>Evidenca 2.31.1 Buxheti i miratuar 2024</i></p> <p><i>Evidenca 2.31 Buxheti i miratuar 2025</i></p> <p><i>Evidenca 2.32.1 Info për grante 2023-2024</i></p> <p><i>Evidenca 2.32 Info për grante 2022-2023</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>GVJ konstaton se procesi i auditimit dhe planifikimi buxhetor i FEUT është i organizuar në përputhje me procedurat institucionale. Auditimet vjetore, të kryera nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm që raporton drejtpërdrejt te Bordi i Administrimit, fokusohen në menaxhimin e fondeve dhe evidentimin e ecurive dhe çështjeve financiare. Planifikimi buxhetor afatmesëm, i miratuar nga Senati Akademik, dhe project buxhetet vjetore bazohen në propozimet e njësisë kryesore, konkretisht të Fakultetit të Ekonomisë dhe të 6</p>

	<p>(gjashtë) departamenteve përkatëse, duke zbatuar parimin e hallkës bazë në planifikim.</p> <p><i>Evidenca 1.1_Statuti_UT</i></p> <p><i>Evidenca 1.4_Rregullore e brendshme e punës së UT "Për organizimin dhe funksionimin e administratës së rektoratit të UT"</i></p> <p><i>Evidenca 2.30.1-3_Projekt buxheti 2024</i></p> <p><i>Evidenca 2.41_Informacion mbi raportin e auditimit nga KLSH dhe reflektimi i rekomandimeve</i></p> <p><i>Evidenca 2.41.1_Program auditimi nga BA për FEUT_2022</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>GVJ konstaton se UT dhe FE raportojnë deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për këtë program të gjitha aspektet e realizimit të buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. Ky proces përfshin analizën e shpenzimeve dhe të ardhurave, duke siguruar transparencë dhe mbikëqyrje efektive të përdorimit të fondeve në përputhje me objektivat e programit.</p> <p><i>Evidenca 1.1_Statuti_UT</i></p> <p><i>Evidenca 2.24_Vendim për miratimin e grantit për prezantim në konferenca dhe botime</i></p> <p><i>Evidenca 2.32.1_Info për grante 2023-2024</i></p> <p><i>Evidenca 2.32_Info për grante 2022-2023</i></p> <p><i>Evidenca 3.11.1_Analiza vjetore 2023-2024_Dept._Kontabilitet</i></p> <p><i>Evidenca 3.11.4_Analiza vjetore e Departamentit Financë_2023-2024</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Universiteti i Tiranës si institucion, si dhe Fakulteti i Ekonomisë si njësi kryesore përgjegjëse për këtë program studimi, tregojnë një qëndrueshmëri financiare të qëndrueshme, duke siguruar mbulimin e shpenzimeve përmes të ardhurave të gjeneruara. Kjo arrihet kryesisht për shkak të numrit të konsiderueshëm të studentëve, si dhe të fitimeve nga projektet e ndryshme të bashkëpunimit me institucione homologe, vendase dhe të huaja. Ky model financimi dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve garanton mbarevajtjen e programit bachelor në "Financë" dhe ofron siguri për zhvillimin e aktiviteteve akademike në vazhdimësi.</p> <p><i>Evidenca 0.3_Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB.</i></p> <p><i>Evidenca 1.34_Vendimi për projektet e kërkimit shkencor të financuar nga UT</i></p> <p><i>Evidenca 2.21_Marrëveshje Ndërinstitucionale</i></p>

	<i>Evidenca 2.31-4_Buxheti i miratuar ndër vite 21-25</i>			
Konkluzione	<i>GVJ evidenton se FEUT ka një plan financiar të detajuar dhe të qëndrueshëm për programin e studimit në "Financë", i cili mbulon kostot për studentët, të ardhurat dhe buxhetet vjetore të miratuara. Procesi i auditimit dhe planifikimit buxhetor siguron transparencë dhe raportim deri në nivelin e njërive bazë, ndërsa qëndrueshmëria financiare e programit, e mbështetur nga numri i studentëve dhe projektet e bashkëpunimit me institucione homologe, garanton mbarevajtjen e programit dhe zhvillimin e aktiviteteve akademike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	<p>Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve, nga hyrja deri te diplomimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p> <p>Këto përfshijnë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Statutin e Universitetit; 2. Rregulloren e Universitetit; 3. Rregulloren e programit të studimit të FEUT; <p>Këto akte nënligjore dhe rregullative përmbajnë në mënyrë të detajuar të gjitha procedurat që përcjellin ecurinë e studentit, nga regjistrimi dhe zhvillimi i programit, deri në përfundim</p>

	<p>dhe diplomim, duke garantuar një proces të drejtë, të qartë dhe transparent.</p> <p><i>Evidenca 1.1_Statuti_UT</i> <i>Evidenca 1.2_Rregullore_UT</i> <i>Evidenca 2.36_Rregullore e programit Bachelor_FEUT</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ vëren se politikat dhe procedurat e ndjekura për ciklin e plotë akademik të studentëve garantojnë barazinë dhe të drejtat e tyre. Të gjitha procedurat shoqërojnë studentin përgjatë gjithë programit të studimit dhe janë të pasqyruara në rregulloren e FEUT. Procesi i miratimit ndiqet nga njësitë përkatëse dhe informacioni është i disponueshëm për publikun në faqen zyrtare të FEUT. Këto procedura mbështesin studentët në çdo hap të përparimit të tyre gjatë ciklit të parë të studimeve në programin “Financë”.</p> <p><i>Evidenca 1.2_Rregullore_UT</i> <i>Evidenca 2.36_Rregullore e programit Bachelor_FEUT</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Bazuar në kuadrin rregullator të përmendur më sipër, GVJ konstaton se kriteret e përgjithshme për përzgjedhjen e kandidatëve fitues për regjistrim në programin e ciklit të parë të studimeve në “Financë” janë të qarta dhe të përcaktuara në mënyrë transparente. Institucioni përcakton kriteret e pranimit dhe kuotat në përputhje me kapacitetet pritëse të Fakultetit të Ekonomisë të UT, duke garantuar një proces të drejtë dhe të balancuar për të gjithë kandidatët e interesuar.</p> <p><i>Evidenca 1.1_Statuti_UT</i> <i>Evidenca 2.36_Rregullore e programit Bachelor_FEUT</i> <i>Evidenca 2.16_Kuota të propozuara_23-24</i> <i>Evidenca 2.17_Kuota të propozuara_25-26</i> <i>Evidenca 2.16.2_Vendim i Dekanit mbi Kriteret e pranimit 2024-2025</i></p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të</p>	<p>Kriteret dhe procedurat për pranimin, përzgjedhjen, përparimin, transferimin, njohjen e studimeve të mëparshme, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin e studentëve janë të përcaktuara qartë dhe në mënyrë të kuptueshme në rregulloret e Universitetit të Tiranës, të Fakultetit të Ekonomisë dhe të programit të studimit Bachelor në “Financë”. Në aktet rregullatore të njësisë kryesore dhe të njësisive bazë përgjegjëse</p>

<p>vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>për këtë program studimi janë specifikuar qartë kriteret për pranimin dhe transferimin e studentëve.</p> <p><i>Evidenca 1.1_Statuti_UT</i> <i>Evidenca 1.2_Rregullore_UT</i> <i>Evidenca 1.12_Rregullore_UT_Diplomim.</i> <i>Evidenca 2.36_Rregullore e programit Bachelor_FEUT</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Departamentet përgjegjëse për programin e studimit në Bachelor në “Financë” organizojnë çdo fillim viti seanca informimi me studentët lidhur me programet e studimit, organizimin e departamenteve dhe kriteret e aplikimit. Ky informacion, përfshirë kriteret e përgjithshme dhe specifike, bëhet gjithashtu publik në faqen zyrtare FEUT si dhe bazohen edhe ne guidën studentore.</p> <p><i>Evidenca 2.16.2_Vendim i Dekanit mbi Kriteret e pranimit 2024-2025</i> <i>Evidenca 3.1_Broshura e Departamenteve</i> <i>Evidenca 2.7_Guida e Studentit FEUT</i> <i>Evidenca 1.1_Statuti_UT</i> <i>Evidenca 1.31_Vendimi i Senatit për Kuotat e pranimit</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret specifike për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, për grupet e pakicave dhe shtresat e marginalizuara. Sipas rregullores së programit të studimit, këta kandidatë kanë të drejtë të aplikojnë, ndërsa propozimet për kuotat janë të përfshira në planifikimet e secilit program. Vendimet e Senatit Akademik përcaktojnë numrin e kuotave të miratuara për secilin program studimi.</p> <p><i>Evidenca 1.2_Rregullore_UT</i> <i>Evidenca 1.31_Vendimi i Senatit për Kuotat e pranimit</i> <i>Evidenca 2.16.2_Vendim i Dekanit mbi Kriteret e pranimit 2024-2025</i> <i>Evidenca 2.36_Rregullore e programit Bachelor_FEUT</i> <i>Evidenca 2.16_Kuota të propozuara_23-24</i> <i>Evidenca 2.17_Kuota të propozuara_25-26</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik</p>	<p>Në kuadrin rregullativ të Universitetit të Tiranës, të përmendur më sipër, nenet dhe kriteret e pranimit përcaktojnë gjithashtu kritere specifike për kandidatët nga shtete të tjera.</p>

<p>kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p><i>Evidenca 1.2_Rregullore_UT</i> <i>Evidenca 1.31_Vendimi i Senatit për Kuotat e pranimit</i> <i>Evidenca 2.16_Kuota të propozuara_23-24</i> <i>Evidenca 2.17_Kuota të propozuara_25-26</i></p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Institucioni harton dhe zbatuar politika për ndihmën dhe bursat studentore, duke synuar mbështetjen e shtresave në nevojë dhe rritjen e cilësisë së pranimit në programet që kanë përparësi për institucionin dhe zhvillimin ekonomik të vendit. Në përputhje me këto politika, UT ofron bursa të plota ose të pjesshme, tarifa të reduktuara për studentët me mesatare të larta akademike, si dhe për ata me vështirësi sociale dhe ekonomike. Njoftimet mbi mundësitë e bursave bëhen publike në faqen zyrtare të Fakultetit të Ekonomisë të UT dhe përfshihen edhe në guidën e studentit.</p> <p><i>Evidenca 1.1_Statuti_UT</i> <i>Evidenca 2.7_Guida e Studentit FEUT</i> <i>Evidenca 2.35.2_Raporti vjetor FEUT 2021-2022</i> <i>Evidenca 2.35.1_Raporti vjetor FEUT 2022-2023</i> <i>Evidenca 2.35_Raporti vjetor FEUT 2023-2024</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se FEUT ka politika dhe procedura të qarta dhe transparente që mbulojnë gjithë ciklin akademik të studentëve, nga hyrja deri te diplomimi. Kriteret e pranimit, përparimit, transferimit dhe diplomimit, përfshirë kandidatët me aftësi të veçanta, grupet e pakicave dhe nga shtetet e tjera, janë të përcaktuara në rregulloret përkatëse.</i></p> <p><i>Informacioni publikohet në faqen zyrtare dhe guidën e studentit, ndërsa bursa dhe tarifa të reduktuara mbështesin studentët me performancë të lartë ose me nevoja sociale-ekonomike, duke garantuar një proces të drejtë dhe barazi në qasje.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e aplikimit pranë ASCAL-it dhe në takimin me studentët dhe stafin akademik gjatë vizitës në institucion, konkludohet se studentët e regjistruar në këtë program marrin informacion mbi ecurinë dhe progresin e tyre akademik përmes disa kanaleve të komunikimit. Informacioni i përgjithshëm ofrohet përmes faqes së internetit të UT dhe, veçanërisht, të FE, ku përditësohen njoftimet, orari mësimor, grafiku i provimeve, datat e eventeve dhe informacione të tjera të rëndësishme. Informacioni specifik për modulet e programit sigurohet në fillim të zhvillimit të lëndës përmes seminarit udhëzues të javës së parë, ku studentët njihen me syllabusin, literaturën bazë dhe ndihmëse, si dhe format e vlerësimit.</p> <p>Një kanal tjetër komunikimi është përdorimi i adresave elektronike të pedagogëve dhe grupeve mësimore, për informacione lidhur me vlerësimet, njoftimet për reklamim etj. Informacion shtesë mund të merret edhe nga faqja zyrtare e pedagogut, sekretaria mësimore dhe broshura e Departamenteve, duke siguruar që studentët të kenë qasje të plotë dhe të përditësuar në të gjitha informacionet e nevojshme për zhvillimin e tyre akademik.</p> <p><i>Evidenca 2.18_Rregullore e Sekretarisë Mësimore, FEUT</i> <i>Evidenca 2.7_Guida e Studentit FEUT</i> <i>Evidenca 3.1_Broshura e Departamenteve</i> <i>Evidenca 2.36_Rregullore e programit Bachelor_FEUT</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e institucionit dhe rregulloren e programit, studentët informohen që në momentin e regjistrimit mbi kriteret dhe procedurat për njohjen e kualifikimeve të mëparshme. Vendimin për pranimin e studentëve e merr Dekani, pas ngritjes së një komisioni ad hoc përgjegjës për renditjen e kandidatëve, ndërsa listat e fituesve bëhen publike në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.</p> <p><i>Evidenca 1.1_Statuti_UT</i> <i>Evidenca 1.2_Rregullore UT</i> <i>Evidenca 2.36_Rregullore e programit Bachelor_FEUT</i> <i>Evidenca 1.9_Rregullore "Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në Universitetin e Tiranës".</i></p>

<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Rregullorja e programit të studimit Bachelor në “Financë” përfshin procedurat e vlerësimit të njohurive dhe format e vlerësimit të dijes në mënyrë të detajuar. Janë përcaktuar qartë llojet e provimeve, provimet e pjesshme dhe ato finale për secilën lëndë, si dhe mënyrat e organizimit të tyre. Forma dhe koha e përbushjes së detyrimeve akademike shpjegohen gjatë orëve të para të kontaktit në javën e parë, në kuadër të seminarit udhëzues midis pedagogut dhe studentëve, dhe përfshihen në syllabusin e lëndës. Studentët informohen mbi vlerësimin e dijeve edhe përmes platformave elektronike e-learning, rrjetit të email-ave institucional të UT dhe FE, si dhe përmes komunikimit të drejtpërdrejtë gjatë takimeve studentë-pedagogë.</p> <p><i>Evidenca 1.2_Rregullore_UT</i> <i>Evidenca 2.36_Rregullore e programit Bachelor_FEUT</i> <i>Evidenca 3.5_Programet mësimore të lëndëve</i> <i>Evidenca 3.8_Screenshot i komunikimeve zyrtare në Teams</i> <i>Takim me stafin akademik dhe studentët gjatë vizitës në institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Departamentet Financë dhe Kontabilitet, përgjegjëse për këtë program studimi informojnë studentët dhe pedagogët udhëheqës për temat e diplomave përmes email-eve zyrtare. GVJ konstatoi nga takimi me studentët se ata janë njohur me kriteret dhe procedurat për përgatitjen dhe mbrojtjen e punimit të mikrotezës, si përmes udhëzuesit të institucionit, ashtu edhe nga pedagogët përkatës dhe udhëheqësit e punimeve, të cilët ndjekin edhe zhvillimin e praktikave të tyre. Për më tepër, informacion shtesë ofrohet edhe përmes faqes së internetit të FEUT.</p> <p><i>Evidenca 1.2_Rregullore_UT</i> <i>Evidenca 2.36_Rregullore e programit Bachelor_FEUT</i> <i>Evidenca 3.14.5_Udhëzues diplome bachelor financë 2024-2025</i> <i>Evidenca 3.14.7_Komunikimi me studentët shpërndarja e diplomave dhe praktikave mësimore</i> <i>Evidenca 3.18_Diploma dhe Supplement diplome</i> <i>Takimi me stafin akademik dhe studentët e programit realizuar gjatë vizitës së GVJ në institucion.</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të</p>	<p>Studentët marrin informacion të plotë që në fazën e aplikimit dhe gjatë gjithë procesit akademik, përmes takimeve pranë Zyrës së Këshillimit të Karrierës, sekretarisë mësimore, udhëzuesve të studentëve, faqes së internetit të institucionit,</p>

<p>lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>burimeve të tjera të përcaktuara, si dhe gjatë open days që organizon FEUT. GVJ vërejtë gjatë takimit me studentët se ata janë njohur me këto informacione dhe i marrin ato në mënyrë të qartë dhe të përditësuar gjatë gjithë procesit të aplikimit dhe më tej.</p> <p><i>Evidenca 2.36_Rregullore e programit Bachelor_FEUT</i> <i>Evidenca 2.25_Aktivitet_Njoftime_Zyra e Karrierës</i> <i>Evidenca 2.26.4_Guida studentore_Keshillimi i karrierës</i> <i>Takim me studentët gjatë vizitës në institucion</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konkludon se UT dhe FE disponojnë dokumentacion të plotë për informimin e studentëve mbi kriteret e pranimit, procedurat e regjistrimit, detyrimet dhe vlerësimin gjatë programit, mbrojtjen e punimeve të diplomës, si dhe kriteret për pranimin dhe transferimin e studentëve.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.3</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>UT dhe FE aplikojnë forma të ndryshme të informimit të studentëve mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit. Përveç takimeve informuese gjatë fazës së aplikimit përmes Zyrës së Këshillimit të Karrierës (ZKK) dhe sekretarisë mësimore, studentët njohin detaje të ndryshme të programit përmes shpalljes së tij, strukturës së programit dhe syllabusve, si dhe gjatë prezantimit të parë që pedagogu i lëndës bën në javën e parë të semestrit për orientimin e studentëve.</p> <p><i>Evidenca 2.36_Rregullore e programit Bachelor_FEUT</i> <i>Evidenca 3.6_Plani mësimor në vite</i> <i>Takim me stafin akademik dhe studentët gjatë vizitës në institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të</p>	<p>Guida e studentit, informacioni i dhënë në vend dhe ai i publikuar në faqen zyrtare të FEUT shërbejnë për periudhën</p>

<p>studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>para regjistrimit të studentëve. Pas regjistrimit, studentët marrin informacion të plotë, periodik dhe të detajuar mbi përmbajtjen e programit, detyrimet lidhur me frekuentimin dhe vlerësimin gjatë vitit akademik dhe në përfundim. Departamentet përgjegjëse për programin e studimit u mundësojnë studentëve informacion të detajuar mbi strukturën, përmbajtjen dhe organizimin e programit të Bachelor në “Financë”.</p> <p><i>Evidenca 2.36_Rregullore e programit Bachelor_FEUT</i> <i>Evidenca 3.6_Plani mësimor në vite</i> <i>Evidenca 3.1_Broshura e Departamenteve</i> <i>Takim me stafin akademik dhe studentët gjatë vizitës në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Bazuar në raportin e RVB-së dhe vizitën në institucion, u konstatua se studentët marrin informacion mbi mundësitë e punësimit pas diplomimit përmes ZKK të Studentëve. Informacioni përditësohet rregullisht dhe studentët mund ta aksesojnë atë përmes të gjitha formave të komunikimit të përmendura më lart. Ata janë të mirëinformuar për mundësitë e punësimit që në fillim të studimeve dhe gjatë gjithë ciklit akademik, duke përfshirë edhe marrëdhëniet e bashkëpunimit të institucionit me aktorë të biznesit në vend.</p> <p><i>Evidenca 2.22_Linqe për Workshop-e, Leksione të hapur dhe Aktivitete të tjera</i> <i>Evidenca 2.25_Aktivitet_Njoftime_Zyra e Karrierës</i> <i>Evidenca 2.26.1_Raport Dita e Karrierës 2025</i> <i>Evidenca 2.26.4_Guida studentore_Keshillimi i karrierës</i> <i>Takim me stafin akademik, studentët dhe Zyrën e Karrierës të FEUT gjatë vizitës në institucion.</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Studentët kanë akses të plotë në informacion përmes të gjitha kanaleve elektronike në kriteret e sipërpërmendura, si dhe përmes kontakteve direkte me stafin akademik të programit, drejtuesit e njësisë kryesore dhe përgjegjëse, ZKK dhe sekretarinë mësimore.</p> <p><i>Evidenca 2.36_Rregullore e programit Bachelor_FEUT</i> <i>Evidenca 2.39_Vendim për emërimin e koordinatorit të studimit</i> <i>Takim me stafin akademik, studentët dhe Zyrën e Karrierës të FEUT gjatë vizitës në institucion.</i></p>

<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Sistemi i informacionit, në të gjitha format e tij të përmendura, është i aksesueshëm edhe për studentët që ndjekin programin në distancë. Gjatë takimit me studentët e programit, ata vlerësuan pozitivisht lehtësinë e marrjes së informacionit.</p> <p><i>Takimi me studentët e programit gjatë vizitës në institucion.</i></p> <p><i>Evidenca 1.28_Manual-Sistemi e-student</i></p> <p><i>Evidenca 1.37_Hapja e adresave Staf dhe Studente ne teams me domain @unitir</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ evidenton se FEUT siguron metoda të ndryshme për informimin mbi organizimin dhe funksionimin e programit të studimeve. Studentët e programit kanë akses të plotë në informacion përmes kanaleve elektronike dhe janë të përfshirë në një platformë të dedikuar për menaxhimin dhe shpërndarjen e informacionit të brendshëm.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi V.4</p>											
<p>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</p>											
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>										
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar dhe vizitën në institucion, gjatë takimit në sekretarinë mësimore u evidentua administrimi i statistikave vjetore për studentët e diplomuar në këtë program studimi. FEUT ruan dhe përditëson çdo vit evidenca dhe statistika që përfshijnë numrin e studentëve të diplomuar për çdo vit akademik. Sipas raportit vjetor, nga viti 2021 deri në vitin 2024, numri total i studentëve të diplomuar është:</p> <table border="1" data-bbox="630 1617 1319 1870"> <thead> <tr> <th>Programi i Studimit</th> <th>Viti Akademik</th> <th>Total i të diplomuarve</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td rowspan="3">Bachelor në Financë</td> <td>2021-2022</td> <td>391</td> </tr> <tr> <td>2022-2023</td> <td>327</td> </tr> <tr> <td>2023-2024</td> <td>290</td> </tr> </tbody> </table>	Programi i Studimit	Viti Akademik	Total i të diplomuarve	Bachelor në Financë	2021-2022	391	2022-2023	327	2023-2024	290
Programi i Studimit	Viti Akademik	Total i të diplomuarve									
Bachelor në Financë	2021-2022	391									
	2022-2023	327									
	2023-2024	290									

	<p><i>Vizita e GVJ në Institucion</i></p> <p><i>Evidenca 0.3_Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB.</i></p> <p><i>Evidenca 2.18_Rregullore e Sekretarisë Mësimore, FEUT</i></p>																						
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Sipas RVB, dokumentacionit të dorëzuar dhe vizitës në institucion, u evidentua administrimi i statistikave vjetore për studentët e regjistruar në këtë program studimi, përfshirë largimet para përfundimit të studimeve. Kjo u konfirmua edhe gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, në regjistrin themeltar të studentëve të këtij programi. Universiteti disponon statistika të detajuara për numrin e studentëve të regjistruar dhe të diplomuar, të cilat sekretaria mësimore ruan dhe përditëson rregullisht, në përputhje me formatet e miratuara nga Ministria e Arsimit.</p> <p>Të dhënat mbi regjistrimet për vitet akademike 2022–2025 duke përfshirë edhe programin në gjuhën angleze janë:</p> <table border="1" data-bbox="628 920 1316 1256"> <thead> <tr> <th>PRS</th> <th>Viti Akademik</th> <th>Të regjistruar (a)</th> <th>Të regjistruar në anglisht (b)</th> <th>Të Transferuar (c)</th> <th>Totali (a)+(b)+(c)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td rowspan="3">Bsc në Financë</td> <td>22 - 23</td> <td>445</td> <td>38</td> <td>8</td> <td>491</td> </tr> <tr> <td>23 - 24</td> <td>435</td> <td>30</td> <td>2</td> <td>467</td> </tr> <tr> <td>24 - 25</td> <td>440</td> <td>24</td> <td>1</td> <td>465</td> </tr> </tbody> </table> <p><i>Evidenca 0.3_Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB.</i></p> <p><i>Vizita e GVJ në institucion</i></p>	PRS	Viti Akademik	Të regjistruar (a)	Të regjistruar në anglisht (b)	Të Transferuar (c)	Totali (a)+(b)+(c)	Bsc në Financë	22 - 23	445	38	8	491	23 - 24	435	30	2	467	24 - 25	440	24	1	465
PRS	Viti Akademik	Të regjistruar (a)	Të regjistruar në anglisht (b)	Të Transferuar (c)	Totali (a)+(b)+(c)																		
Bsc në Financë	22 - 23	445	38	8	491																		
	23 - 24	435	30	2	467																		
	24 - 25	440	24	1	465																		
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore të FEUT, GVJ konstatoi se të dhënat mbi ecurinë akademike të studentëve të programit menaxhohen në mënyrë të strukturuar përmes sistemit të brendshëm të informacionit. Këto përfshijnë regjistra të printuar dhe dokumente elektronike, si procesverbalet e provimeve, riprovimeve dhe regjistrin themeltar. Sistemi e-student garanton ruajtjen e konfidencialitetit dhe mundëson akses të shpejtë në informacion si për studentët, ashtu edhe për auditimin dhe verifikimin nga organet përkatëse. Evidencat rezultojnë të përputhshme me dokumentacionin zyrtar, duke krijuar një bazë të plotë dhe të besueshme të të dhënave akademike.</p>																						




	<p><i>Evidenca 1.28_Manual-Sistemi e-student.</i></p> <p><i>Evidenca 1.29_Rregullore-për-funksionimin-e-sistemit-informatik</i></p> <p><i>Evidenca 2.18_Rregullore e Sekretarisë Mësimore, FEUT</i></p> <p><i>Vizita e GVJ në institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njërive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe në verifikimet gjatë vizitës në institucion, GVJ vëren se FEUT zbaton praktika të rregullta kontrolli mbi administrimin dhe përditësimin e të dhënave të studentëve. Sekretaria mësimore mban evidenca të strukturuar, të cilat përfshijnë procesverbalet e provimeve, regjistrin themeltar dhe dokumentacionin mbështetës, të cilat menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit. Institucioni garanton ruajtjen e saktësisë, përputhshmërisë dhe konfidencialitetit të të dhënave, në përputhje me aktet rregullative dhe ligjore në fuqi.</p> <p><i>Evidenca 1.28_Manual-Sistemi e-student.</i></p> <p><i>Evidenca 1.29_Rregullore-për-funksionimin-e-sistemit-informatik</i></p> <p><i>Vizita e GVJ në institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>FEUT, harton në mënyrë të rregullt raportet vjetore të analizës mësimore-shkencore për programin e studimit. Në këto raporte pasqyrohen ecuria e procesit mësimor, cilësia e pranimeve dhe diplomimeve të studentëve, si dhe identifikohen problematikat dhe detyrat prioritare për përmirësim të mëtijshëm. GVJ konstaton se këto raporte përbëjnë një instrument të rëndësishëm për vlerësimin dhe planifikimin e zhvillimit të programit.</p> <p><i>Evidenca 3.20_Analiza e tregut_Alumni-Program studimi_Dhjetor 2022</i></p> <p><i>Evidenca 3.2 Pyetësor studim i tregu të punës i të diplomuarve në programin e studimit</i></p> <p><i>Evidenca 3.11.1-6_Analiza vjetore e Departamenteve_21-24</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konkludon se institucioni plotëson kriteret lidhur me hartimin dhe zbatimin e politikave për informimin, ndjekjen dhe dokumentimin e plotë të ciklit akademik të studentëve, nga regjistrimi deri në diplomim.</i></p> <p><i>Procedurat janë të përcaktuara qartë në aktet rregullative të UT dhe FE, dhe informacioni menaxhohet në mënyrë të sigurt dhe të kontrollueshme përmes sistemit të brendshëm informativ dhe dokumentacionit zyrtar.</i></p>

73

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Universiteti i Tiranës, në zbatim të Ligjit 80/2015, statutit dhe rregullores së tij, garanton studentëve përfaqësim në proceset vendimmarrëse dhe këshilluese në nivel institucioni, duke përfshirë Senatin Akademik, Këshillin e Etikës, Komisionin e Kurrikulës, NJSBC, si dhe në nivel të Fakultetit të Ekonomisë, përmes NJSBC dhe Grupi të Vetëvlerësimit në kuadër të proceseve të akreditimit të programeve.</p> <p>Në bazë të rregullores së UT, funksionon Këshilli i Studentëve, i cili përfaqëson dhe mbron interesat e studentëve. U evidentua pjesëmarrja aktive e studentëve në këto organe vendimmarrëse dhe në takimet që ato zhvillojnë, siç dokumentohet në vendimet përkatëse të ngritjes dhe funksionimit të këtyre strukturave.</p> <p><i>Evidenca 1.1_Statuti_UT</i> <i>Evidenca 1.2_Rregullore_UT</i> <i>Evidenca 1.13_Rregullore për zgjedhjet e këshillave të studentëve në UT</i> <i>Evidenca 1.20_Vendimi nr. 51 "Për miratimin e paketës së dokumentave për sigurimin e cilësisë UT.</i> <i>Evidenca 1.24_Vendimet për zgjedhjen e anëtareve të komisioneve të perhershme_UT_2025</i> <i>Evidenca 1.30_Vendim për regjistrimin e studentëve për kandidim për anëtarë Senati UT.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të</p>	<p>Nga shqyrtimi i dosjes së aplikimit të institucionit pranë ASCAL-it dhe nga takimi me studentët gjatë vizitës së GVJ në institucion, u evidentua se studentët dhe përfaqësuesit e tyre luajnë një rol aktiv në organet vendimmarrëse. Ata kontribuojnë gjithashtu në vlerësimin periodik të cilësisë së mësimdhënies, duke marrë pjesë në anketime anonime dhe diskutime direkte me titullarët e lëndëve përkatëse të</p>

<p>jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>programit. Përveç kësaj, në RVB të programit, një nga anëtarët e grupit është student, duke garantuar përfaqësim dhe pjesëmarrje të vazhdueshme në proceset e vlerësimit dhe përmirësimit të programit.</p> <p><i>Evidenca 1.1_Statuti_UT</i> <i>Evidenca 1.2_Rregullore_UT</i> <i>Evidenca 0.5_Krijimi i GVB_FEUT</i> <i>Evidenca 2.35_Raporti vjetor FEUT 2023-2024</i> <i>Evidenca 2.8.1_Vendim 2021 për miratimin e NJSBC në FEUT</i> <i>Takimi me studentët e programit gjatë vizitës në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Përfshirja e studentëve në rishikimin dhe përmirësimin e programit realizohet kryesisht përmes vlerësimeve të mbledhura nga anketat për programin dhe pedagogët e lëndëve, të organizuara nga NJSBC, si dhe nga diskutimet direkte me pedagogët. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të aplikimit dhe verifikimi gjatë vizitës në institucion, <i>GVJ vëren se nuk ka pasur ndryshime në kurrikulën e programit prej vitit 2022, megjithatë, pedagogët kanë integruar tema të reja që pasqyrojnë zhvillimet më të fundit teknologjike dhe shërbimet e institucioneve bankare brenda lëndëve përkatëse.</i></p> <p><i>Evidenca 1.21_Paketa e instrumentave të cilësisë UT.</i> <i>Evidenca 1.22_Vlerësimi i lëndës nga studenti</i> <i>Evidenca 1.23_Vlerësimi për pedagogun</i> <i>Takimi me studentët e programit gjatë vizitës në institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Bazuar në kuadrin rregullator të institucionit dhe në takimin e GVJ me studentët e programit, u vërejt se ata kanë mundësinë të shprehin mendimet e tyre për përmirësimin e programit dhe të japin input lidhur me procesin e mësimdhënies. Përfshirja realizohet kryesisht përmes anketave për programin dhe pedagogët e lëndëve, të organizuara nga NJSBC, si dhe nga diskutimet direkte me pedagogët.</p> <p>Nga takimi me studentët nuk u evidentuan ankesa për vlerësimin e dijeve, ndërsa ata shprehën opinion pozitiv për procesin. Gjithashtu, institucioni disponon kuadrin rregullativ dhe udhëzimet përkatëse që mbështesin këtë proces, duke garantuar të drejtën e ankimit dhe pjesëmarrjen aktive të studentëve në përmirësimin e programit.</p>

	<p><i>Evidenca 1.2_Rregullore_UT</i></p> <p><i>Evidenca 2.36_Rregullore e programit Bachelor_FEUT</i></p> <p><i>Evidenca 3.3_Manuali i zhvillimit të provimeve të Departamentit të Financës</i></p> <p><i>Takimi me studentët e programit gjatë vizitës në institucion</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se studentët kanë akses të plotë në informacion mbi strukturën, përmbajtjen dhe organizimin e programit përmes kanaleve elektronike, stafit akademik dhe Zyrës së Karrierës.</i></p> <p><i>Ata përfshihen në organet vendimmarrëse dhe kanë mundësinë të shprehin opinionet e tyre. Institucioni, njësia kryesore dhe dy njësitë bazë kanë fokus të veçantë rolin e rëndësishëm që kanë studentet në procesin e realizimit të objektivave të programit</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>Bazuar në strukturën administrative të UT, institucionit i janë krijuar mekanizma të qartë për informimin dhe mbështetjen e studentëve, të mbështetur nga aktet rregullative të miratuara nga strukturat vendimmarrëse. Në nivel rektorati funksionon Drejtoria e Komunikimit me tre sektorë, ku Sektori i Marrëdhënieve me Studentët ndjek informacionin e studentëve në forma të ndryshme.</p> <p>Në Fakultetin e Ekonomisë në Departamentin e Financës dhe në Departamentin e Kontabilitetit, studentët informohen përmes Zyrës së Shërbimeve, Zyrës së Karrierës dhe Zyrës së Informacionit, ndërsa guida e studentit dhe faqja zyrtare e FE të UT ofrojnë informacion të detajuar dhe të përditësuar. Shtesë informacioni ofrohet përmes komunikimit elektronik, platformave e-learning si Microsoft Teams, dhe rrjeteve sociale ku fakulteti dhe departamentet janë aktive.</p>

	<p><i>Evidenca 2.26.4_Guida studentore_Keshillimi i karrierës</i></p> <p><i>Evidenca 2.7_Guida e Studentit FEUT</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Strukturat e informimit të studentëve, veçanërisht në nivel fakulteti dhe departamentesh, kanë krijuar një sistem të plotë dhe dinamik komunikimi, i cili mbulon gjithë ciklin e programit të studimit, nga regjistrimi deri te diplomimi. Informimi realizohet kryesisht përmes Sekretarisë Mësimore, Zyrës së Informacionit dhe Zyrës së Këshillimit të Karrierës, si dhe përmes kontakteve direkte me stafin akademik dhe njësinë bazë të institucionit. Në fillim të çdo viti akademik, Fakulteti i Ekonomisë organizon Javën e orientimit, ku studentët njoftohen me detaje mbi strukturën dhe përmbajtjen e programit, platformat elektronike, format e vlerësimit dhe modelin e lëndëve. Ky sistem mbështetet edhe nga përdorimi i platformave elektronike, rrjeteve sociale dhe ekraneve të instaluar në ambientet e përbashkëta të fakultetit, duke siguruar shpërndarje të shpejtë, të qartë dhe të vazhdueshme të informacionit për studentët.</p> <p><i>Evidenca 2.7_Guida e Studentit FEUT</i></p> <p><i>Evidenca 3.1_Broshura e Departamenteve</i></p> <p><i>Vizita e GVJ në FEUT</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Një strukturë kyçe për informimin e studentëve është Zyra e Këshillimit të Karrierës, e cila, përveç këshillimit të kandidatëve për regjistrim në program, ofron informacion mbi mundësitë e punësimit, trajnimeve dhe praktikave. Zyra ndjek të gjithë procesin e informimit për studentët, duke bashkëpunuar me struktura të tjera të institucionit për të garantuar një informacion të plotë dhe të saktë. Po ashtu, Zyra ruan lidhje të ngushta me tregun e punës, duke orientuar studentët për mundësi praktike dhe mundësi punësimi pas përfundimit të studimeve.</p> <p><i>Evidenca 2.25_Aktivitet_Njoftime_Zyra e Karrierës</i></p> <p><i>Evidenca 2.26_Raport mbi Qendrën e Karrierës</i></p> <p><i>Evidenca 2.26.1_Raport Dita e Karrierës 2025</i></p> <p><i>Evidenca 2.27_Udhëzim mbi funksionimin e zyrës së Karrierës</i></p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna</p>	<p>Zyra e Këshillimit të Karrierës monitoron vazhdimisht punësimin e studentëve gjatë periudhës së studimeve, si dhe pas diplomimit. Çdo vit akademik, ajo harton një raport analitik, përditësuar sipas çdo niveli programi, duke përfshirë</p>

<p>mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>të dhënat mbi punësimin dhe progresin profesional të studentëve. Ky informacion vendoset në dispozicion të studentëve dhe strukturave drejtuese për të mbështetur vendimmarrjen dhe orientimin profesional.</p> <p><i>Evidenca 3.2 Pyetësor studim i tregu të punës i të diplomuarve në programin e studimit</i></p> <p><i>Evidenca 3.20.1 Studentë të punësuar të diplomuar qershor 2025</i></p> <p><i>Evidenca 3.20 Analiza e tregut Alumni-Program studimi Dhjetor 2022</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>FEUT ka struktura të dedikuara për monitorimin e progresit dhe ecurisë së programit të studimit Bachelor në "Financë". Sekretaria Mësimore dhe ZKK përbëjnë kanalet kryesore të informimit të studentëve, për periudhën para regjistrimit, gjatë zhvillimit të programit dhe pas diplomimit.</i></p> <p><i>Këto zyra mbikëqyrin progresin akademik të studentëve dhe ofrojnë mbështetje për zhvillimin e karrierës së tyre, duke siguruar informacion të përditësuar, të verifikueshëm dhe të aksesueshëm për të gjithë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

<p>Standardi VI.1</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e aplikimit, Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) dhe takimet e zhvilluara me stafin akademik dhe studentët e programit, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) konstaton se Universiteti i Tiranës ka struktura dhe procedura të qarta dhe funksionale për sigurimin e</p>

<p>dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>brendshëm të cilësisë, në përputhje me strategjinë institucionale dhe kuadrin ligjor në fuqi.</p> <p>Institucioni ka të plotë kuadrin rregullativ që mbështet funksionimin e sistemit të brendshëm të cilësisë, përfshirë politikat dhe procedurat e UT, të cilat kanë në fokus përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Në nivel institucional është ngritur Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), e cila funksionon në përputhje me rregulloren përkatëse të miratuar nga UT. Strategjia e Zhvillimit 2023–2028 përfshin masa konkrete për integrimin e metodave inovative në procesin mësimor. Gjithashtu, vlen të theksohet se për vlerësimin dhe korrigjimin e provimeve po aplikohet platforma CleanScore.</p> <p><i>Evidenca 1.3_Strategjia e Zhvillimit të UT_2023-2028</i></p> <p><i>Evidenca 3.8_Screenshot i komunikimeve zyrtare në Teams</i></p> <p><i>Evidenca 3.15_Model flete provimi_korrigjim me Clean Score</i></p> <p><i>Evidenca 1.36_Marrëveshje Bashkëpunimi mes AADF dhe UT për programin Clean Score</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Bazuar në Statutin e UT, organigramën institucionale, dokumentacionin e Fakultetit të Ekonomisë (FE), Manualin e Cilësisë dhe takimet e zhvilluara në institucion, GVJ konstaton se monitorimi dhe vlerësimi periodik i aftësisë mësimdhënëse të stafit realizohet nga Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë (KPSSC) dhe Komisioni i Përhershëm i Kurrikulës. Ky proces mbështetet nga Rregullorja “Për sigurimin e cilësisë në UT” dhe instrumentet përkatëse të cilësisë, që përfshijnë edhe funksionimin e Njësisë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (NJSBC).</p> <p>Në nivel fakulteti, FE ka ngritur Degën e Sigurimit të Cilësisë dhe NJSBC-në përkatëse, që operojnë sipas rregullore institucionale. Këto struktura monitorojnë dhe vlerësojnë mësimdhënien përmes analizës së performancës akademike të stafit të Departamentit të Financës dhe të Kontabilitetit, si dhe përmes anketimeve me studentët në fund të çdo semestri. Rezultatet përpunohen në raporte dhe i paraqiten instancave vendimmarrëse. Një tjetër formë vlerësimi është edhe hartimi, në fillim të vitit, i planit individual të ngarkesës mësimor-shkencore për çdo pedagog, i cili monitorohet nga drejtuesit e departamenteve dhe fakultetit. Përmbushja e këtij plani është tregues i performancës akademike.</p>

79

	<p><i>Nga shqyrtimi i të dhënave rezulton se disa pedagogë mbulojnë 5–6 lëndë në disa programe studimi, me një ngarkesë mësimore prej 400–450 orësh në vit, e konsideruar relativisht e lartë.</i></p> <p><i>Evidenca 1.1_Statuti_UT</i></p> <p><i>Evidenca 1.4_Rregullore e brendshme e punës së UT “Për organizimin dhe funksionimin e administratës së rektoratit të UT”</i></p> <p><i>Evidenca 1.24_Vendimet për zgjedhjen e anëtareve të komisioneve të perhershme_UT_2025</i></p> <p><i>Evidenca 1.23_Vlerësimi për pedagogun</i></p> <p><i>Evidenca 2.9_Rregullore e Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë FEUT</i></p> <p><i>Evidenca 0.3_Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Bazuar në kuadrin rregullativ të UT dhe FE, vlerësimi periodik i mësimdhënies dhe veprimtarisë akademike e administrative realizohet nëpërmjet strukturave përkatëse institucionale, duke u mbështetur si në instrumente të vlerësimit të strukturuar, ashtu edhe në feedback-un e studentëve.</p> <p>Studentët përfshihen në këtë proces përmes anketave të organizuara në fund të çdo semestri, të cilat përfshijnë vlerësimin e lëndëve, pedagogëve dhe praktikës profesionale. Të dhënat e mbledhura përpunohen në raporte analitike që shpërndahen tek stafi akademik dhe analizohen në mbledhjet e departamenteve për të ndihmuar në përmirësimin e procesit mësimor dhe në vlerësimin e performancës së pedagogëve në fund të vitit akademik.</p> <p>Po ashtu, përdoren formularë të standardizuar për vlerësimin e stafit, veçanërisht në rastet e pedagogëve me kontrata të përkohshme, ku evidentohen kontributet në mësimdhënie, kërkimin shkencor dhe angazhimin institucional.</p> <p><i>Megjithatë, vihet re nevoja për të forcuar përfshirjen aktive të studentëve në këtë proces, për të siguruar një pasqyrë më të plotë dhe të besueshme të cilësisë së mësimdhënies.</i></p> <p><i>Evidenca 1.1_Statuti_UT</i></p> <p><i>Evidenca 2.9_Rregullore e Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë FEUT</i></p> <p><i>Evidenca 1.21_Paketa e instrumentave të cilësisë UT</i></p> <p><i>Evidenca 1.22_Vlerësimi i lëndës nga studenti</i></p> <p><i>Evidenca 1.17_Manuali i Cilësisë UT</i></p>

<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Strukturat përgjegjëse për monitorimin e cilësisë së mësimdhënies, përkatësisht NJSBC e Fakultetit të Ekonomisë dhe Departamentave të Financës dhe Kontabilitetit, hartojnë dhe shpërndajnë raporte periodike vlerësimi, të cilat u vihen në dispozicion strukturave drejtuese në nivel fakulteti dhe departamenti, si dhe pedagogëve dhe palëve të tjera të interesuara. GVJ konstaton se NJSBC, referuar rregullores së saj, raporton fillimisht vlerësimet e mbledhura tek stafi akademik dhe më pas tek strukturat vendimmarrëse të fakultetit. Këto raporte diskutohen në nivel departamenti dhe shërbejnë si bazë për ndërhyrje dhe përmirësime të vazhdueshme në cilësinë e mësimdhënies.</p> <p><i>Evidenca 3.11.1 Analiza vjetore 2023-2024 Dept. Kontabilitet</i> <i>Evidenca 3.11.4 Analiza vjetore e Departamentit Financë 2023-2024</i> <i>Evidenca 2.10.1 Raporte të NJSBC-së</i> <i>Takimi me stafin akademik të programit gjatë vizitës në institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Bazuar në informacionin e mbledhur nga Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB) dhe nga vizita në institucion, gjatë takimeve me stafin akademik të programit, GVJ konstatoi se institucioni përdor mekanizma të sistemuar vlerësimi që shërbejnë për identifikimin dhe promovimin e praktikave të mira në mësimdhënie.</p> <p>Analiza e raporteve të vlerësimeve të personelit, e cila zhvillohet në nivel njësie kryesore dhe njësie bazë, diskutimet konstruktive në mbledhjet e departamenteve dhe përfshirja e stafit në projekte si programi ERASMUS+ kontribuojnë në nxitjen e përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies. Eksperiencia dhe kualifikimi i stafit akademik që zhvillon programin përbëjnë një faktor kyç për realizimin me cilësi të objektivave mësimore dhe për forcimin e praktikave të mira brenda institucionit.</p> <p><i>Evidenca 3.11.1 Analiza vjetore 2023-2024 Dept. Kontabilitet</i> <i>Evidenca 3.11.4 Analiza vjetore e Departamentit Financë 2023-2024</i> <i>Evidenca 1.21 Paketa e instrumentave të cilësisë UT</i> <i>Evidenca 1.22 Vlerësimi i lëndës nga student</i> <i>Evidenca shtesë: Lista e mobiliteteve për stafin dhe studentët</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni ka mekanizma efektivë për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, përmes analizës së</p>

	<p><i>raporteve, diskutimeve në departament dhe duke promovuar praktikat e mira dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies.</i></p> <p><i>Është e nevojshme rritja e numrit të studentëve të përfshirë aktivisht në proces, për të garantuar një vlerësim më të plotë dhe objektiv të cilësisë.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.2	
<p>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Universiteti i Tiranës, në zbatim të kërkesave të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, pika 1, ka hartuar politika të mirëpërcaktuara dhe ka ngritur struktura funksionale për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), si në nivel institucional ashtu edhe në nivel njësie kryesore, përkatësisht në FEUT që mbulon programin Bachelor në ‘Financë’. GVJ konstaton se janë miratuar akte nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e brendshme të institucionit në funksion të cilësisë së programeve të studimit. Baza rregullative e këtij sistemi mbështetet në Manualin e Sigurimit të Cilësisë dhe në rregulloren përkatëse, të miratuara nga Senati Akademik. Për zbatimin konkret të këtij kuadri janë ngritur dhe funksionojnë Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC), si dhe Njësitë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) në nivel institucional dhe në njësitë kryesore, në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p> <p><i>Evidenca 1.1_Statuti_UT</i> <i>Evidenca 1.17_Manuali i Cilësisë UT.</i> <i>Evidenca 2.8_Vendimi për përbërjen e Komisionit të NJSBC</i> <i>Evidenca 2.8.1_Vendim 2021 për miratimin e NJSBC në FEUT</i> <i>Evidenca 2.9.2_Udhëzues për sigurimin e cilësisë FEUT</i></p>

	<p><i>Evidenca 2.9 Rregullore e Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë FEUT</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Në nivel institucional, strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë janë Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve dhe të Cilësisë (KPSSC) dhe Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë. Në nivel njësie kryesore, pranë FEUT, funksionon NJSBC, e cila ndjek, monitoron dhe kontribuon në përmirësimin e cilësisë në proceset mësimore dhe shkencore.</p> <p>Kjo strukturë përbëhet nga 8 anëtarë, përfshirë edhe një përfaqësues të studentëve, duke garantuar përfaqësim të balancuar në procesin e vlerësimit. NJSBC bashkëpunon ngushtë me njësitë bazë të fakultetit, veçanërisht me koordinatoret e programeve të studimit dhe me departamentet përkatëse. Bazuar në rregulloren e funksionimit të saj, kjo njësi përdor një sërë metodash vlerësimi, përfshirë anketimet dhe takimet me studentët, si dhe diskutimet me koordinatoret e programeve. Në përfundim të procesit të mbledhjes së informacionit, NJSBC harton një raport periodik ku evidentohen problematikat dhe gjetjet kryesore, të cilat i paraqiten strukturave përgjegjëse në nivel institucional, të fakultetit dhe të departamenteve për analizë dhe ndërhyrje të mëtejshme.</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti UT</i></p> <p><i>Evidenca 2.8 Vendimi për përbërjen e Komisionit të NJSBC</i></p> <p><i>Evidenca 2.8.1 Vendim 2021 për miratimin e NJSBC në FEUT</i></p> <p><i>Evidenca 2.9 Rregullore e Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë FEUT</i></p> <p><i>Evidenca 1.20 Vendimi nr. 51 "Për miratimin e paketës së dokumentave për sigurimin e cilësisë UT.</i></p> <p><i>Evidenca 2.10 Plan veprimi i NJSBC FEUT</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e</p>	<p>GVJ vëren se sigurimi i jashtëm i cilësisë në Universitetin e Tiranës realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm dhe akreditimit, në bashkëpunim me Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL). UT është akredituar së fundmi me Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 04, datë 27.01.2023, duke plotësuar standardet institucionale të kërkuara. Ky akreditim është i vlefshëm deri më 26.01.2029. Paralelisht, në UT ka nisur procesi i akreditimit edhe për disa programe të tjera studimi. Për realizimin e këtyre proceseve, ngrihen Grupet e Vlerësimit të Brendshëm (GVB), të cilat</p>

<p>krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>funksionojnë në përputhje me Manualin e Sigurimit të Cilësisë të institucionit.</p> <p><i>Evidenca 2.8.1_Vendim 2021 për miratimin e NJSBC në FEUT</i> <i>Evidenca 2.9_Rregullore e Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë FEUT</i> <i>Evidenca 2.9.1_Aktiviteti i NJSBC Material përmbledhës_2022-2025</i> <i>Evidenca 2.9.2_Udhëzues për sigurimin e cilësisë FEUT</i> <i>Evidenca 2.10.1_Raporte të NJSBC-së</i> <i>Evidenca 2.10_Plan veprimi i NJSBC FEUT</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>GVJ vlerëson se në rregulloret dhe manualët e UT dhe FE paraqitet qartë politika e institucionit për sigurimin dhe përmirësimin periodik të cilësisë së programeve të studimit. Vlerësimi i cilësisë realizohet përmes pyetësorëve të studentëve dhe vlerësimit të performancës së stafit akademik nga NJSBC, sipas kritereve të përcaktuara, ku rezultatet përfshihen në raportin vjetor dhe i bëhen të ditura strukturave përgjegjëse.</p> <p><i>Evidenca 1.3_Strategjia e Zhvillimit të UT_2023-2028</i> <i>Evidenca 1.17_Manuali i Cilësisë UT.</i> <i>Evidenca 1.14_Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT</i> <i>Evidenca 1.21_Paketa e instrumentave të cilësisë UT.</i> <i>Evidenca 1.22_Vlerësimi i lëndës nga studenti</i> <i>Evidenca 1.23_Vlerësimi për pedagogun</i> <i>Evidenca shtesë: Mbi rezultatet e përfituara nga "Paketa e Instrumentave të Cilësisë"</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ thekson se UT ka politika dhe struktura të qarta për sigurimin dhe përmirësimin periodik të cilësisë së programeve të studimit. Vlerësimi i cilësisë realizohet përmes pyetësorëve të studentëve dhe monitorimit të performancës së stafit akademik nga NJSBC, ku rezultatet raportohen te strukturat përgjegjëse dhe përfshihen në raportin vjetor, duke garantuar një proces të qëndrueshëm dhe të institucionalizuar të cilësisë.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi VI.3

84

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi nga RVB dhe dokumentacioni i aplikimit pranë ASCAL-it se në Fakultetin e Ekonomisë përdoren metoda të ndryshme për vlerësimin e cilësisë, përfshirë kontrollet nga drejtuesit e Njesisë Kryesore, analizat dhe diskutimet në mbledhjet e departamentit dhe fakultetit, si dhe anketimet e studentëve.</p> <p>Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) përmbledh dhe analizon pyetësorët, duke informuar strukturat përkatëse, përfshirë departamentin dhe dekanatin. Vlerësimin dhe monitorimin e cilësisë realizojnë gjithashtu Departamenti i Financës dhe ai i Kontabilitetit, si njësi që mbulojnë programin Bachelor në “Financë”. Rezultatet e monitorimit dhe vlerësimit prezantohen në mbledhjet përkatëse dhe përfshihen në raportet vjetore të departamenteve.</p> <p><i>Evidenca 2.8.1_Vendim 2021 për miratimin e NJSBC në FEUT</i> <i>Evidenca 2.8_Vendimi për përbërjen e Komisionit të NjsBC</i> <i>Evidenca 3.11.1 Analiza vjetore 2023-2024_Dept. Kontabilitet</i> <i>Evidenca 3.11.4 Analiza vjetore e Departamentit Financë_2023-2024</i></p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>GVJ konstatoi nga RVB se, në nivel institucional, NJSBC harton çdo vit akademik Raportin e Vlerësimit të Brendshëm, i cili ofron një analizë të funksionimit institucional të UT-së dhe të përmbushjes së standardeve të cilësisë për vitin akademik. Ky raport përmbledh evidencat që shërbejnë për vlerësimin e standardeve të cilësisë në veprimtaritë akademike dhe mësimore, duke mundësuar identifikimin e nevojave dhe vendosjen e synimeve për zhvillimin e cilësisë. Megjithatë, në raportet e NJSBC-së për këtë program studimi, u vu re një pjesëmarrje e ulët e studentëve në anketime.</p> <p><i>Evidenca 3.2 Pyetësor studim i tregu të punës i të diplomuarve në programin e studimit</i> <i>Evidenca 2.9.1 Aktiviteti i NJSC Material përmbledhës_2022-2025</i> <i>Evidenca 2.10 Plan veprimi i NJSBC FEUT</i> <i>Evidenca 2.10.1 Raporte të NJSBC-së</i></p>

<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndër-institucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>GVJ evidentoi nga RVB edhe planin e punës të NJSBC për vitin akademik 2024–2025. Disa nga instrumentet kryesore të përdorura nga këto struktura, veçanërisht NJSBC, janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimet e moduleve të lëndëve nga studentët; - Vlerësimet e pedagogut nga studentët; - Formularët e vlerësimit nga personeli akademik. <p>NJSBC përmbledh dhe analizon pyetësorët, duke informuar strukturat përkatëse, përfshirë departamentet dhe dekanatin. Monitorimi dhe vlerësimi i cilësisë kryhet gjithashtu nga Departamenti i Financës dhe Departamenti i Kontabilitetit, si njësi që mbulojnë programin bachelor në “Financë”, duke përfshirë edhe aktivitetin kërkimor shkencor të stafit. Rezultatet e monitorimit dhe vlerësimit prezantohen në mbledhjet e organizuara dhe përfshihen në raportet vjetore të departamenteve.</p> <p><i>Evidenca 2.10.1_Raporte të NJSBC-së</i> <i>Evidenca 3.11.1_Analiza vjetore 2023-2024_Dept. Kontabilitet</i> <i>Evidenca 3.11.4_Analiza vjetore e Departamentit Financë_2023-2024</i> <i>Vizita në institucion dhe takimet me stafin akademik.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e</p>	<p>GVJ vlerëson se institucioni ka implementuar metoda dhe instrumente të tërthorta për vlerësimin e realizimit, mbarëvajtjes dhe cilësisë së programit të studimit. Këto përfshijnë sondazhet dhe intervistat me studentët, alumni, personelin akademik, ndihmësakademik dhe administrativ, punëdhënësit dhe institucionet partnerë, si dhe palët e tjera të përfshira në procesin mësimor dhe vlerësimin e dijeve dhe kompetencave të fituara. Rezultatet e këtyre vlerësimeve përpunohen dhe i komunikohet strukturave përgjegjëse, duke kontribuar në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit.</p> <p><i>Evidenca 1.14_Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT</i> <i>Evidenca 1.17_Manuali i Cilësisë UT.</i> <i>Evidenca 1.21_Paketa e instrumentave të cilësisë UT.</i> <i>Evidenca 3.20_Analiza e tregut Alumni-Program studimi_Dhjetor 2022</i> <i>Evidenca 3.2 Pyetësor studim i tregu të punës i të diplomuarve në programin e studimit</i> <i>Evidenca shpesh: Të dhëna mbi aktivitetin dhe veprimtarinë e Njësisë së Sigurimit të Cilësisë (NJSBC) dhe Raportimin, FEUT, 2022-2025</i></p>

dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se UT ka struktura dhe instrumente të qarta për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve, përfshirë vlerësime nga studentët, alumni, stafi akademik dhe bashkëpunëtorët.</i> <i>Të dhënat përpunohen nga NJSBC dhe strukturat përkatëse dhe raportohen në mbledhje dhe raportet vjetore.</i>
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet
	Përmbushet pjesërisht
	Përmbushet kryesisht
	Përmbushet plotësisht
	X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, dokumentacionin e aplikimit pranë ASCAL-it dhe të dhënat e marrë gjatë takimeve gjatë vizitës në UT, GVJ konstatoi se kuadri rregullator i institucionit garanton përfshirjen e të gjithë aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në proceset e sigurimit dhe përmirësimin të vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit. Manuali i Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë përcakton organizimin, funksionet, përgjegjësitë dhe detyrat e sektorëve përbërës, si dhe dokumentacionin e nevojshëm për realizimin e vlerësimit të brendshëm. <i>Evidenca 1.14_Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT</i> <i>Evidenca 1.17_Manuali i Cilësisë UT.</i> <i>Evidenca 1.21_Paketa e instrumentave të cilësisë UT.</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe	Në rregulloret dhe udhëzimet përkatëse të institucionit dhe njësisë kryesore/bazë të programit përcaktohen qartë roli dhe përgjegjësitë e të gjitha njësive të përfshira në monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së programit. Në nivelin e Fakultetit Ekonomik të UT, Dega e Sigurimit të Cilësisë dhe NJSBC koordinojnë aktivitetet dhe ndajnë përgjegjësi të përbashkëta për realizimin e këtyre proceseve.

<p>garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p><i>Evidenca 1.1_Statuti_UT</i> <i>Evidenca 1.2_Rregullore_UT</i> <i>Evidenca 1.14_Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT</i> <i>Evidenca 2.9_Rregullore e Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë FEUT</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.</p>	<p>GVJ vlerëson se UT garanton përfshirjen aktive të personelit akademik dhe studentëve në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit, duke respektuar integritetin akademik dhe duke shmangur çdo formë diskriminimi ose pabarazie. NJSBC përbëhet nga anëtarë të stafit akademik, përfaqësues të njësisë kryesore. Gjithashtu, në hartimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB), krahas stafit akademik të programit, pjesë e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm është edhe një student.</p> <p><i>Evidenca 0.5_Krijimi i GVB_FEUT</i> <i>Evidenca 1.14_Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT</i> <i>Evidenca 1.17_Manuali i Cilësisë UT.</i> <i>Evidenca 1.21_Paketa e instrumentave të cilësisë UT.</i> <i>Vizita në Institucion nga GVJ</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Në njësitë e ngritura për vlerësimin e cilësisë janë të përfaqësuar si stafi akademik ashtu edhe studentët. GVJ nuk evidentoi asnjë rast pabarazie ndaj personelit apo studentëve, pasi analizat kryhen në mënyrë transparente dhe vendimmarrja është e përbashkët për të gjithë anëtarët e njësisë. Në nivel institucional, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përbëhet nga anëtarë të stafit akademik, të cilët respektojnë integritetin akademik dhe shmangin çdo formë diskriminimi ose pabarazie.</p> <p><i>Evidenca 0.5_Krijimi i GVB_FEUT</i> <i>Evidenca 1.14_Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT</i></p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të</p>	<p>GVJ vërejtë gjatë vizitës në institucion se UT angazhon bashkëpunëtorë dhe ekspertë të jashtëm të fushës së ekonomisë dhe financës në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë. Në përbërjen e NJSBC përfshihen ekspertë të jashtëm me njohuri të specializuara.</p> <p>Aktivitetet si Panairi i Punës, leksionet e hapura me personalitete të fushës, si dhe marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione publike dhe private, janë kthyer në traditë universitare dhe përdoren nga strukturat përkatëse për të</p>

japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	<p>diskutuar dhe përmirësuar vazhdimisht cilësinë e programeve të studimit.</p> <p><i>Evidenca 1.14_Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT</i></p> <p><i>Evidenca 1.21_Paketa e instrumentave të cilësisë UT.</i></p> <p><i>Evidenca 2.9_Rregullore e Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë FEUT</i></p> <p><i>GVJ gjatë vizitës në Institucion</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ vlerëson se UT përfshin aktivisht ekspertë dhe bashkëpunëtorë të jashtëm në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë, duke përdorur gjithashtu aktivitete institucionale si Panairi i Punës dhe leksionet e hapura për të diskutuar dhe përmirësuar vazhdimisht programet e studimit.</i></p>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Në aktet rregullative të institucionit, përfshirë rregulloren e UT, rregulloren e NJSBC dhe rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë, përcaktohet gjithashtu transparenca e rezultateve lidhur me SBC.</p> <p>Gjetjet dhe problematikat që dalin nga raportet periodike të njësive përkatëse adresohen pranë njësive kryesore dhe bazë për t'u diskutuar dhe për të gjetur zgjidhje që synojnë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.</p> <p><i>Evidenca 1.1_Statuti_UT</i></p> <p><i>Evidenca 1.2_Rregullore_UT</i></p> <p><i>Evidenca 2.9_Rregullore e Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë FEUT</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe</p>	<p>Institucioni ka publikuar në faqen zyrtare të UT vendimin e akreditimit institucional të datës 27.01.2023, i vlefshëm për gjashtë vite akademike deri më 26.01.2029. Informacioni në nivel programi dhe departamenti përcillet tek strukturat përkatëse përmes shkresave zyrtare, ndërsa studentët informohen përmes faqes zyrtare dhe platformës e-student,</p>

<p>legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>duke respektuar lirinë dhe etikën akademike si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p> <p><i>Evidenca 1.35_Akreditimi Institucional_UT.</i></p> <p><i>Evidenca 1.9_Rregullore "Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në Universitetin e Tiranës".</i></p> <p>https://unitir.edu.al/akreditimi-periodik-i-universitetit-te-tiranes/</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Në nivel institucional, UT, bazuar në vendimin e akreditimit të vitit 2023, ka hartuar një plan masash për adresimin e mangësive të evidentuara dhe për zbatimin e rekomandimeve të dhëna. Ky program studimi, që është në akreditim për herë të parë në Departamentin e Financës dhe Departamentin e Kontabilitetit, monitorohet dhe vlerësohet vazhdimisht. Problematikat e evidentuara diskutohen gjithashtu gjatë analizës vjetore të veprimtarisë, e cila organizohet çdo vit për të siguruar përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit.</p> <p><i>Evidenca 1.14_Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT</i></p> <p><i>Evidenca 3.11.1_Analiza vjetore 2023-2024_Dept._Kontabilitet</i></p> <p><i>Evidenca 3.11.4_Analiza vjetore e Departamentit Financë_2023-2024</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e RVB, GVJ konstatoi se në UT realizohen periodikisht analiza në nivel fakulteti dhe departamenti mbi zbatimin e politikave dhe strategjive, duke reflektuar ndryshimet dhe përmirësimet e nevojshme. Pas analizës mësimore-shkencore në departament, organizohet gjithashtu analiza vjetore e veprimtarisë në nivel të Fakultetit Ekonomik. Në bazë të këtyre analizave, NJSBC ka hartuar planin e veprimit për vitin 2024-2025. Periodikisht, realizohet edhe dita e informimit për studentët potencialë të programit, ku u ofrohet informacion i detajuar për regjistrimin.</p> <p><i>Evidenca 2.34_Aktivitet kërkimi shkencor_FEUT_2023-2024</i></p> <p><i>Evidenca 2.35_Raporti vjetor FEUT 2023-2024</i></p> <p><i>Evidenca 3.11.1_Analiza vjetore 2023-2024_Dept._Kontabilitet</i></p> <p><i>Evidenca 3.11.4_Analiza vjetore e Departamentit Financë_2023-2024</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin</p>	<p>Vlerësimi i cilësisë së programit diskutohet në takimet e njësisë bazë, Departamenti i Financës dhe Departamenti i Kontabilitetit dhe në njësinë kryesore Fakulteti Ekonomik i</p>

90

dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	<p>UT. Gjatë ditës së informimit për studentët potencialë, u ofrohet informacion i plotë dhe i strukturuar mbi standardet dhe nivelin e cilësisë së programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca 2.10.2_Plani kalendar NJSBC_22-25</i> <i>Evidenca 2.10_Plan veprimi i NJSBC FEUT</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ vlerëson se UT publikon informacion të qartë dhe të detajuar mbi sigurimin e cilësisë për studentët dhe të gjithë palët e interesuara. Materialet dhe raportet e analizave respektojnë etikën akademike dhe legjislacionin për të dhënat personale, përfshijnë tregues të matshëm të efektivitetit të aktiviteteve dhe sigurojnë ndërgjegjësimin dhe përfshirjen aktive të personelit dhe studentëve në procesin e sigurimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Financë”

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. FE si njësi kryesore dhe dy njësitë bazë DF dhe DK përgjegjëse të programit kanë kapacitetet akademike tashmë të konsoliduar prej vitesh duke fituar reputacionin brenda dhe jashtë vendit dhe duke garantuar zhvillimin me sukses të këtij programi studimi në të dy gjuhët që ai ofrohet, shqip dhe anglisht;
2. Në nivel institucional, njësi kryesore dhe njësi bazë të programit janë një numër i madh marrëveshjesh bashkëpunimi me aktorë të brendshëm dhe institucione homologe jashtë vendit duke ju mundësuar stafit akademik dhe studentëve mobilitetet e nevojshme;
3. Ky program studimi do ta konsideronim jo vetëm me historikun më të gjatë në Shqipëri por edhe si më i konsoliduar parë kjo në ecurinë e suksesshme të aplikimeve në fazën e regjistrimit dhe preferencës së tregut për të diplomuarit në këtë program;
4. FE si njësi kryesore dhe DF dhe DK si njësi bazë të programit janë aktive në përfshirjen e studentëve dhe aktorëve të tjerë institucional dhe sipërmarrjes private në përmirësimin e programit të studimit me qëllim përmirësim të mundshëm të programit në funksion të nevojave

të tregut të punës në financë dhe kontabilitet nëpërmjet organizimeve të ëorkshopeve, tryezave të rumbullakëta dhe konferencave studentore;

5. GVJ evidenton se arrihet një vlerësim i drejtë i dijeve të studentëve duke respektuar konfidencialitetin, paanësinë dhe të drejtën e ankimit nga studentët dhe zgjidhjes së saj;
6. Personeli akademik i angazhuar në program ka tituj akademikë dhe ekspertizë specifike në fushën e financës, duke siguruar një nivel të lartë profesional për mësimdhënie (*Standardi IV.1*)
7. Eksperienca dhe kualifikimi i stafit akademik që zhvillon programin përbëjnë një faktor kyç për realizimin cilësor të objektivave mësimore dhe për forcimin e praktikave të mira brenda institucionit;
8. Përputhshmëri me ngarkesën mësimore, pasi numri i pedagogëve PAE është në përputhje me standardet, duke garantuar mbulimin e të gjitha lëndëve të programit;
9. Institucioni ofron mjedise mësimore të përshtatura dhe infrastrukturë të posaçme që mbështet realizimin e procesit mësimdhënës dhe aktivitetet praktike të programit, në përputhje me natyrën dhe fushën e studimit;
10. Institucioni siguron burime financiare të qëndrueshme dhe mbështetje të mjaftueshme për realizimin e procesit mësimor dhe kërkimor, si dhe për zhvillimin dhe mbështetjen e studentëve gjatë programit të studimit;
11. UT përfshin aktivisht ekspertë dhe bashkëpunëtorë të jashtëm në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë dhe përdor aktivitete institucionale, si Panairi i Punës dhe leksionet e hapura, për të diskutuar dhe përmirësuar vazhdimisht programet e studimit;

b. Pika të dobëta:

1. Programi Bachelor në “Financë” nuk ka patur përditësime të planit mësimor që prej vitit 2022, përveç rishikimeve të kufizuara në nivel lëndësh, të cilat lidhen kryesisht me përfshirjen e zhvillimeve të fundit teknologjike në përmbajtjen mësimore; (*Standardi II.1. Kriteri 2*)
2. Përfshirja e studentëve në procesin e vlerësimit të cilësisë duhet të zgjerohet dhe të forcohet, duke rritur numrin e studentëve të përfshirë në këtë proces, me qëllim që të sigurohet një pasqyrë më e plotë, gjithëpërfshirëse dhe e besueshme mbi cilësinë e mësimdhënies; (*Standardi VI.1; Kriteri 3*)

Rekomandime:

1. Institucioni në një të ardhme të afërt të mund të përditësojë planin mësimor brenda kufirit 20 % kompetencë e tij, për ti paraprirë zhvillimeve në tregun e punës dhe teknologjisë financiare;
2. Rekomandohet që institucioni të forcojë dhe zgjerojë përfshirjen më aktive të studentëve në procesin e vlerësimit të cilësisë, duke rritur numrin e pjesëmarrësve dhe nivelin e angazhimit të tyre. Kjo do të kontribuojë në sigurimin e një vlerësimi më gjithëpërfshirës, të balancuar dhe të besueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe të përvojës akademike në tërësi;

Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor in "Finance"

a. Strengths and affirmations:

1. FE as the main unit and the two basic units DF and DK responsible for the program have academic capacities already consolidated for years, gaining a reputation inside and outside the country and guaranteeing the successful development of this study program in both languages that it is offered, Albanian and English;
2. At the institutional level, the main unit and basic unit of the program are a large number of cooperation agreements with domestic actors and homologous institutions abroad, enabling academic staff and students the necessary mobilities;
3. We would consider this study program not only with the longest history in Albania but also as the most consolidated, given the successful performance of applications in the registration phase and the market preference for graduates in this program;
4. FE as the main unit and DF and DK as the basic units of the program are active in involving students and other institutional actors and private entrepreneurship in improving the study program with the aim of possible improvement of the program in function of the needs of the labor market in finance and accounting through the organization of workshops, round tables and student conferences;
5. GVJ evidences that a fair assessment of students' knowledge is achieved by respecting confidentiality, impartiality and the right of students to complain and resolve it;
6. The academic staff engaged in the program hold academic titles and possess specific expertise in the field of finance, ensuring a high professional standard in teaching;
7. The experience and qualifications of the academic staff delivering the program constitute an essential factor for achieving high-quality learning outcomes and strengthening good practices within the institution;
8. Teaching load alignment is ensured, as the number of teaching staff (PAE) corresponds to the standards, guaranteeing full coverage of all program courses;
9. The institution provides appropriate learning environments and specialized infrastructure that support the teaching process and practical activities of the program, in accordance with the nature and field of study;
10. The institution ensures sustainable financial resources and adequate support for the implementation of the teaching and research process, as well as for the development and assistance of students throughout the program;
11. UT actively involves external experts and collaborators in the evaluation and quality assurance processes and utilizes institutional activities, such as the Job Fair and open lectures, as platforms to continuously discuss and improve the study programs;

b. Weaknesses:

1. The Bachelor Program in Finance has not undergone curriculum updates since 2022, except for a few limited course-level revisions primarily related to the integration of recent technological developments into the course content; (*Standard II.1, Criterion 2*)



93



2. The involvement of students in the quality assurance process should be expanded and strengthened, by increasing the number of students participating in this process, in order to ensure a more comprehensive, inclusive, and reliable overview of the quality of teaching; *(Standard VI.1, Criterion 3)*

Recommendation

1. The institution should be able to update the curriculum within 20% of its competence in the near future to anticipate developments in the labor market and financial technology;
2. It is recommended that the institution strengthen and expand the active involvement of students in the quality assurance process, by increasing the number of participants and their level of engagement. This will contribute to ensuring a more comprehensive, balanced, and reliable assessment of the quality of teaching and of the overall academic experience;

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

